



MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES

STRATEGJIA NDERSEKTORIALE PER ZHVILLIMIN RAJONAL

DOKUMENT – FINAL

(Aprovuar me vendim Nr.773, dt.14.11.2007 te Keshillit te Ministrave)

TETOR 2007

Tabela e Përmbajtjes

Shkurtime & Akronime	<u>3</u>
Fjalor termash	<u>4</u>
0. Permbledhje Ekzekutive	<u>7</u>
0.1 Hyrje	<u>7</u>
0.2 Zhvillimi Rajonal ne Shqiperi	<u>7</u>
0.3 Vizioni i Qeverise	<u>8</u>
0.4 Programi Kombetar per Zhvillimin e Qarqeve (PKZHQ)	<u>8</u>
0.5 Programi i Zhvillimit te Zonave Jo te Favorizuara (PZHJF)	<u>9</u>
0.6 Kuadri Ligjor per Zhvillimin Rajonal	<u>10</u>
0.7 Kuadri Institucional per Zhvillimin Rajonal	<u>10</u>
0.8 Implikimet e burimeve	<u>11</u>
1. Veshtrim i pergjithshem	<u>12</u>
1.1 Hyrje	<u>12</u>
1.2 Zhvillimi Rajonal ne Shqiperi	<u>12</u>
1.2.1 Nen-ndarja administrative dhe statistikore e Shqiperise.....	<u>12</u>
1.2.2 Pabarazite rajonale ne Shqiperi.....	<u>15</u>
1.2.3 Instrumentet ekzistues te adresimit te pabarazive rajonale	<u>17</u>
2. Vizioni, prioritetet dhe synimet.....	<u>18</u>
2.1 Vizioni	<u>18</u>
2.2 Synimet	<u>18</u>
2.3 Objektivat strategjike	<u>18</u>
2.3.1 Objektivi Strategjik 1: Të gjitha qarqet të kontribuojnë në zhvillimin dhe konkurrencën e qëndrueshme të Shqipërisë	<u>20</u>
2.3.2 Objektivi Strategjik 2: Një kuadër efikas manaxhimi për zhvillimin rajonal.....	<u>22</u>
3. Politikat	<u>24</u>
3.1 Programi Kombetar per Zhvillimin e Qarqeve (PKZHQ)	<u>24</u>
3.2 Programi i Zhvillimit te Zonave Jo te Favorizuara (PZHJF)	<u>28</u>
3.3 Kuadri Ligjor per Zhvillimin Rajonal	<u>32</u>
3.3.1 Ligji mbi Zhvillimin Rajonal	<u>32</u>
3.3.2 Fleksibiliteti ne ligjin mbi Zhvillimin Rajonal	<u>34</u>
3.3.3 Marreveshja e Zhvillimit te Qarkut	<u>34</u>
3.4 Kuadri Institucional për Zhvillimin Rajonal	<u>35</u>
3.4.1 Këshilli i Partneritetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal (KPKZHR).....	<u>36</u>
3.4.2 Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë (Departamenti i Programimit Strategjik) .	<u>37</u>
3.4.3 Ministrinë e Linjes.....	<u>38</u>
3.4.4 Këshilli i Partneritetit te Qarkut	<u>39</u>
3.4.5 Këshilli i Qarkut.....	<u>39</u>
3.4.6 Agjencia e Zhvillimit te Qarkut391	
4. Implikimet e burimeve	<u>41</u>
5. Kontabilizimi, monitorimi dhe vleresimi	<u>43</u>
Aneks 1: Procesi i konsultimit per finalizimin e Strategjise Ndersektoriale	

te Zhvillimit Rajonal	44
Aneks 2: Keshilli i Partneritetit Kombetar i perkohshem	56
Aneks 3: Strategjia e Zhvillimit te Qarkut - nje baze e mundeshme	59
Aneks 4: Marreveshja e Zhvillimit te Qarkut - nje baze e mundeshme	62

Shkurtime & Akronimet

PV	Plani i Veprimit
AZHQ	Agjencia e Zhvillimit të Qarkut
PZHQ	Programi i Zhvillimit të Qarkut
SZHQ	Strategjia e Zhvillimit të Qarkut
KPQ	Këshilli i Partneritetit të Qarkut
ZJF	Zona Jo të Favorizuara
PZHJF	Programi i Zhvillimit të Zonave Jo të Favorizuara
KE	Komisioni European
BE	Bashkim European
EUROSTAT	Agjencia e Statistikave të Bashkimit European
PKB	Prodhimi Kombëtar Bruto
IZHNJ	Indeksi i Zhvillimit Njerëzor
IPP	Instrumenti për Para-Pranim
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjis
MF	Ministria e Financave
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin
KPKZHR	Këshilli i Partneritetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal
NJNST	Njësitë e Nomenklaturës së Statistikave Territoriale
SNZHR	Strategjia Ndersektorale per Zhvillimin Rajonal
GP	Grupi i Punës (Nën-Komiteti i Këshillit të Partneritetit të Qarkut përgjegjës për zhvillimin e zonave jo të favorizuara)

Fjalor termash

Aktiviteti: Veprimi do të mbështetet mbi një masë.

Qarku: një rajon i Shqipërisë i njohur në shqip me termin “Qark”

Programi i Zhvillimit të Qarkut: Një program nën Strategjinë Ndersektorale të Zhvillimit Rajonal objektivi i së cilës është të lehtësojë themelimin e një sistemi të vetëm të menaxhimit dhe planifikimit të zhvillimit rajonal në vend.

Agjencia e Zhvillimit të Qarkut: Një agjenci jo-fitim-prurëse e themeluar në rang qarku. Kjo agjenci nxit dhe mbështet përpjekjet për zhvillim në të gjithë qarkun. AZHQ do të ndihmojë Këshillat e Partneritetit të Qarkut në punën e tyre, do të ndërmarrë një kërkim, do të lehtësojë konsultimet me grupet e interesit local, do të përgatisë dokumentet strategjike dhe do të sigurojë mbështetje në zbatimin e Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut. Nga ana institucionale, ka disa opsione për strukturën dhe natyrën e AZHQ, por secili prej tyre duhet të pranohet formalisht nga Qeveria para se të njihet formalisht si një AZHQ.

Marrëveshja e Zhvillimit të Qarkut: një marrëveshje ndërmjet qeverisë qendrore dhe qarkut mbi angazhimet për mbështetjen financiare nga qeveria qendrore, qarku dhe bashkitë/komunat për realizimin e prioritetëve për të cilat është rënë dakort më parë brenda strategjisë së zhvillimit të qarkut.

Strategjia e Zhvillimit të Qarkut: Plani i zhvillimit social-ekonomik për qarkun përgatitur me pjesëmarrjen e plotë të të gjithë pjesëmarrësve përkatës së zhvillimit në atë nivel.

Këshilli i Partneritetit të Qarkut: Një komitet konsultues dhe këshillues në nivelin e qarkut anëtarësia e të cilit mund të jetë nga të gjitha organet përkatëse shtetërore që punojnë në nivelin e qarkut: qeverië e Qarkut, bashkisë dhe komunës; partnerët socialë dhe sindikatat e biznesit dhe tregtisë në nivelin e qarkut; organizatat e shoqërisë civile (d.m.th. OJQ-të); përfaqësues të qeverisë qendrore.

Programi i Zhvillimit të Zonave Jo të Favorizuara: Një program nën Strategjinë Ndersektorale të Zhvillimit Rajonal, objektivi i të cilit është të eliminojë mosbarazitë ndërmjet zonave jo të favorizuara dhe mesatares kombëtare në Shqipëri.

Zonat Jo të Favorizuara: Zonat e kategorizuara nga Qeveria si jo të favorizuara. Zonat Jo të Favorizuara ndahen në dy kategori: Komunitat/bashkitë jo të favorizuara (NJAL 2) dhe Qarqet jo të favorizuara (NNJST 3). Komunitat dhe bashkitë jo t[favorizuara janë ato të cilat janë përcaktuar në Kategoritë 1 dhe 2 dhe Qarqet Jo të Favorizuar në kategoritë 1 dhe 2 sipas Modelit të ri të zhvillimit Social-ekonomik (shiko Modelin e zhvillimit social-ekonomik).

Vlerësimi: vlerësimi i ndërhyrjes publike konsiston në gjykimin e vlerës së tij në lidhje me kriteret e përcaktuara qartë, dhe mbi bazën e informacionit që është mbledhur dhe analizuar në mënyrë të vacantë.

Synimi (ose qëllimi): deklarata e potë e synimit strategjik për të gjithë planin strategjik.

Impakti: influenca e gjerë, afat-gjatë e veprimit të zhvillimit ose ndërhyrjes. (p.sh. shifrat në punësim pas një viti/ aktiviteti i rritur i aktivitetit të biznesit për shkak të aksesit më të lehtë)

INTERREG: Një iniciativë e BE për të forcuar kohezionin ekonomik dhe social nëpërmjet BE, duke përkrahur zhvillimin e ekuilibruar të kontinentit nëpërmjet bashkëpunimit ndër-kufitar, ndër-shtetëror dhe

ndër-rajonal. Një theks i vacantë vendoset mbi integrimin e rajoneve të largëta dhe ato rajone që ndodhen në kufi me vendet candidate për t'u pranuar në BE.

Ndërhyrja: Qeveria synon të influencojë mbi sjelljen e tregut me qëllim që të përmirësojë situatën aktuale (për të arritur objektivat e politikës së qeverisë).

Projektet e zhvillimit të përbashkët: Projektet e bashkëpunimit ndërmjet dy ose më shumë qarqeve dhe identifikuar në Strategjitë e Zhvillimit të Qarkut të qarqeve që dëshirojnë të bashkëpunojnë mes tyre. "Projekte të tilla të zhvillimit të përbashkët do të inkurajohen nëpërmjet shpërndarjes në rritje të financimeve, kërkesave të kufizuara për bashkë-financim dhe ponderimit selektiv.

Njësia Lokale Administrative 2: Një nën-ndarje analitike e vendit – e cila më pare është përshkruar si NNJTS niveli 5.

Masa: Njësia bazë e menaxhimit të programit; mjeti nëpërmjet të cilit një prioritet zbatohet në disa vite gjë që mundëson financimin e operacioneve.

Modeli i Zhvillimit Social-Ekonomik: Një model i cili do të zhvillohet për të lejuar kategorizim të qartë të të dy qarqeve dhe bashkive/komunave bazuar në nivelin e zhvillimit të tyre social-ekonomik. Qëllimi kryesor i modelit të ri do të jetë masa objective e ndryshimeve sociale dhe ekonomike ndërmjet njësive territoriale. Modeli përdoret për të përcaktuar disa kategori të jo-favorizimit për njësitë e vetë-qeverisjes locale dhe për qarqet (shiko Zonat Jo të Favorizuara).

Monitorimi: Një shqyrtim i thellë dhe i rregullt i burimeve, produkteve dhe rezultateve të ndërhyrjeve publike. Monitorimi i sistemit të informacionit sigurohet kryesisht nga operatorët dhe përdoret kryesisht për të drejtuar ndërhyrjet publike. Kur monitorimi përfshin një gjykim, ky gjykim i referohet arritjes së objektivave operacionale. Monitorimi është kryesisht përgjegjësi e aktorëve që janë ngarkuar me zbatimin e një ndërhyrjeje.

Këshilli i Partneritetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal: një organ këshillues i nivelit kombëtar i përbërë nga përfaqësues të sektorëve publikë (administrata qendrore shtetërore, qarqet, bashkitë dhe komunat), private dhe civilë dhe do të themelohet në përputhje me Ligjin për Zhvillimin Rajonal. Ky këshill është krijuar me qëllimin për të siguruar këshillim që lidhet me përgatitjen, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Ndersektorilae të Zhvillimit Rajonal, duke koordinuar subjekte të ndryshme dhe duke marrë pjesë në planifikimin e zhvillimit rajonal. Funkzioni sekretariat i KPKZHR sigurohet nga METE.

Nevojat: problemi ose vështirësia që ndikon grupet e interesuara, të cilin synon ta zgjidhi ose ta kapërcejë ndërhyrja publike.

NNJST: "Nomenklatura e Njësive Statistikore Territoriale (NNJST)" krijuar nga Zyra e Statistikave e Komuniteteve Europiane (EUROSTAT) në bashkëpunim me institucionet kombëtare për statistikat. Sistemi i NNJST siguron një nën-ndarje statistikore dhe administrative të vendit.

NNJST 3: Niveli i tretë i nën-ndarjes së një vendi. Rajonet NNJST 3 pritet të kenë një popullsi prej 150,000 dhe 800,000. Në Shqipëri kjo mund të barazohet me rajonin normativ – qarkun.

Objektivi: Qëllimi i synuar i aktiviteteve që do ndërmerren; një objektivi që i shtohet qëllimit, rafinon fokusin dhe referohet drejt nivelit tjetër të strategjisë, drejt prioritetit.

Produktet: Mallrat dhe shërbimet që prodhohen nga një ndërhyrje (p.sh. kurse trajnimi për të pa-punët me afat të gjatë).

Partneriteti: Bashkëpunimi ndërmjet pjesmarrësve (aktorët publikë, privatë dhe OJQ) për të punuar së bashku për të arritur objektivat e përbashkëta.

Politika: një grup aktivitete të ndryshme (programe, procedura, ligje, rregulla) që drejtohen drejt një synimi të vetëm ose objektivit të përgjithshëm. Këto aktivitete shpesh grumbullohen në rritje gjatë viteve.

Prioriteti: Objektivat të cilat synojnë zbatimin në lidhje me strategjinë e gjerë. Ky përcakton zonat e gjera të politikës dhe ndërhyrjes strategjike.

Programi: një grup i organizuar i burimeve financiare, organizative dhe i burimeve njerëzore të mobilizuara për të arritur objektivin ose grupin e objektivave në një hapësirë të caktuar kohore. Një program është i pakufizuar për sa i përket një programi dhe buxheti. Tre hapat kryesore në ciklin e jetës së një programi janë hartimi, zbatimi dhe vlerësimi *ex post*.

Projekti: operacioni i pandashëm, i pakufizuar për sa i përket programit dhe buxhetit, dhe vendosur nën përgjegjësinë e një operatori.

Rajoni: Në këtë dokument përfshihet një nën-ndarje jo specifike por xhenerike të territorit kombëtar. Rajonet mund ose të jenë rajone normative: shprehja e një vullneti politik; limitet e tyre janë përcaktuar sipas detyrave që janë përcaktuar për komunitetet territoriale, sipas përmasave të popullsisë që janë të nevojshme për të zbatuar në mënyrë eficiente dhe ekonomike këto detyra, dhe sipas faktorëve të tjerë historikë, kulturorë dhe faktorë të tjerë; ose rajone analitike (ose funksionale): përcaktuar sipas kërkesave analitike; ato i grupojnë zonat së bashku duke përdorur kriteret gjeografike (p.sh., lartësinë ose llojin e tokës) ose duke përdorur kriteret social-ekonomike (p.sh., homogjeniteti, përputhshmërinë ose polaritetin e ekonomive rajonale).

Ponderimi selektiv: Përdorimi i kriterëve të veçanta që favorizojnë përzgjedhjen e projekteve në “zonat jo-të favorizuara”

Strategjia: përzgjedhja e veprimeve prioritare sipas urgjencës së nevojave që do të plotësohen, rendësisë së problemeve që do të zgjidhen, dhe shanseve të veprimeve që parashikohen të jenë të suksesshëm. Në formulimin e një strategjie, objektivat përzgjidhen dhe gradohen, si dhe vendosen dhe nivelet e tyre të ambicies.

Vizioni: një deklaratë e situates që dëshirohet të jetë në të ardhmen; vizioni vjen nga qëllimi.

Grupi i Punës për Zonat Jo të Favorizuara: Një nën-komitet i Këshillit të Partneritetit të Qarkut që do të marrë pjesë në përgatitjen dhe menaxhimin e seksionit të “Zhvillimit të Zonave Jo të Favorizuara” të Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut për qarkun e tyre.

0. Permbledhje Ekzekutive

0.1 Hyrje

1 Komiteti i Planifikimit Strategjik në Këshillin e Ministrave ka sanksionuar formulimin e një Strategjie Ndersektoriale të Zhvillimit Rajonal (SNZHR) dhe ka caktuar Ministrinë e Ekonomisë që të drejtojë përgatitjen e tij. Qeveria e Shqipërisë ka identifikuar¹ nevojën për një politikë të integruar, koherente rajonale bazuar në shqetësimin e saj në rritje për boshllëqet që po thellohen gjithnjë e më shumë në performancën social-ekonomike dhe pasurive ndërmjet pjesëve të ndryshme të vendit. SNZHR është menduar si një element kyç i Strategjisë së re Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin (SKZHI)².

2 Kjo strategji ndersektoriale per zhvillimin rajonal ka kaluara nëpërmjet një procesi të gjere dhe te plotë konsultimi me partnerët e Qeverisë.

3 Një dokument tjetër – Plani i Veprimit për SNZHR – vendos veprimet dhe kuadrin kohor për zbatimin e strategjise.

0.2 Zhvillimi Rajonal në Shqipëri

4 Ndarja territoriale e Shqipërisë udhëhiqet nga Ligji Nr.. 8652/00 (për organizimin dhe funksionimin e Qeverive Lokale) dhe Ligji 8653/00 (për ndarjen Administrative Territoriale). Ky legjislacion e ka ndarë vendin në dy nivele: qarqet dhe komunat/bashkitë. Qarqet përfaqësojnë një njësi administrative territoriale me një popullsi mesatare (në 2004) prej 260,605 (shiko hartën më poshtë). Qarqet nëndahen në rrethe (por keta te fundit nuk jane më një nën-ndarje normative e vendit pas kalimit të dy ligjeve që përshkruhen më sipër).

5 Këshillat e komunës, bashkisë dhe qarkut janë organet përfaqësuese të qeverive lokale. Komunitat dhe bashkitë formohen me përfaqësuesit e zgjedhur direct, ndërsa anëtarët e këshillit të qarkut zgjidhen nga këshillat e komunave dhe bashkive brenda jurisdiksionit të qarkut nga kolegët e tyre në këto këshilla. Kryetarët e bashkive dhe Kryetarët e Këshillave të Komunave janë anëtarë *ex officio*. Këshillat e Qarkut kanë përgjegjësi ligjore për planifikimin dhe koordinimin e veprimeve me interes rajonal (planifikimi i zhvillimit rajonal). Megjithatë, baza e kufizuar e burimeve (fiskale dhe njerëzore) dhe pranimi i kufizuar nga niveli i bashkisë/komunës dhe nga niveli kombëtar nënkuptonte që këshillat e qarkut duhet ende ta përmbushnin këtë rol në mënyrë më efikase.

6 Pabarazia rajonale eshte prezente ne orme ekstreme ne Shqiperi: Varferia eshte 66% me e larte ne zonat rurale se ne Tirane dhe 50% me e larte se ne qendrat e tjera kryesore urbane. Tirana ka nje indeks te PBB prej 0.772 perkundrejt nje indeksi te PBB prej 0.252 te nje pjese te zonave malore dhe nje indeks te zhvillimit njerezor 0.830 perkundrejt nje indeksi prej 0.632 te zonave malore.

7 Pabarazite paraqiten ekstreme: p.sh. niveli I papunesise ne Kukës eshte mbi tre here me I larte se ne Tirane, niveli I varferise ne Kukës eshte mbi dy here me I larte se ne Vlore, popullsia ne Vlore kane dy here me teper akses ne furnizimin me uje te pijshem se ata ne Diber, banoret e Tiranës kane 2,5 here me teper akses ne drejtim te vizitave mjeksore se ata ne Kukës.

¹ Nëpërmjet Programit të Qeverisë të Shtatorit 2005 dhe Strategjisë Kombëtare të saj për Zhvillimin Social-Ekonomik të 2001

² Sistemi i Planifikimit të Integruar, i cili u miratua nëpërmjet Vendimit 692 të Këshillit të Ministrave në Nëntor 2005, vendos kuadrin e planifikimit strategjik. Kjo është përpunuar më tej nëpërmjet: (a) vendimit të Komitetit të Planifikimit Startegjik për planifikimin strategjik (Mars 2006); dhe (b) Udhëzimi për Përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (Maj 2006)

8 Migrimi i brendshem rezulton me pabarazi te brendeshme masive: ndermjet viteve 2005 dhe 2006 popullsia e Tiranës është rritur me 137,000 dhe ajo e Durrësit me 43,000 banorë, ndërsa popullsia e Dibres paksohet me 43,000 (një reduktim prej 23% e popullsisë së Qarkut) dhe ajo e Kukësit me 30,000 (një reduktim 27% e popullsisë së Qarkut)

9 Matja e dizavantazheve në nivel rrethi tregon se pabarazia rajonale është pabarazisht e shpërndarë edhe Brenda qarkut. I njëjti model i shpërndarjes së pabarazisë paraqitet edhe në nivel komune brenda të njëjtit rreth, duke demonstruar se ekzistojnë komuna të pa favorizuara brenda qarqeve me të pafavorizuara.

0.3 Vizioni I Qeverisë

10 Deklarata e vizionit të Qeverisë për SNZHR është: “Një rritje e qëndrueshme dhe e ekuilibruar social-ekonomike ndërmjet rajoneve të Shqipërisë, në përgjithësi, dhe zonave malore dhe periferike, në veçanti, me qëllim që të mbështetet një zhvillim i shpejtë i të gjithë vendit dhe të përshpejtohen proceset e integritimit në BE dhe NATO”.

11 Ky vizion do të arrihet nepermjet dy objektivave strategjike:

- Objektivi Strategjik 1: synon që të sigurojë që të gjitha qarqet të jenë në gjendje të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe konkurrencën – dhe në këtë mënyrë të reduktojnë pabarazitë sociale dhe ekonomike në të gjithë vendin
- Objektivi Strategjik 2: synon në krijimin e një kuadri efikas menaxhimi për zhvillimin rajonal.

12 Objektivi Strategjik 1 do të arrihet nepermjet realizimit të dy programeve: Programit Kombëtar për Zhvillimin e Qarqeve dhe Programit të Zhvillimit të Zonave të Pa Favorizuara.

13 Objektivi Strategjik 2 do të arrihet nepermjet nxjerrjes së Ligjit për Zhvillimin Rajonal dhe akteve nenligjore perkatëse dhe nepermjet zhvillimit të strukturave të nevojshme institucionale për të menaxhuar politikën rajonale.

1.4 Programi Kombëtar i Zhvillimit të Qarqeve (PKZHQ)


14 Qëllimi i këtij programi është të lehtësojë krijimin e një sistemi planifikimi dhe menaxhimi të vetëm të zhvillimit rajonal në vend.

15 PKZHQ prezanton një grup elementesh të rinj në politikën rajonale të Shqipërisë:

- Një kuadër të vetëm të politikës për zhvillimin social-ekonomik të qarqeve, duke marrë parasysh nevojat e tyre specifike për zhvillim;
- Një partneritet të ri ndërmjet pjesëmarrësve kombëtarë, të qarkut, të bashkisë dhe komunës – Keshilli I Partneritetit të Qarkut;
- Një dokument i vetëm i programimit të zhvillimit social-ekonomik për qarkun – Strategjia e Zhvillimit të Qarkut – dhe një agjenci e vetme lokale për të koordinuar zbatimin e saj – Agjencia e Zhvillimit të Qarkut.

- Koncepti i “marrëveshjes për zhvillimin e qarkut”: një plan i pranuar financiar, operacional dhe strategjik shumë-vjeçar i cili parashtron mbështetjen e qeverisë qendrore për prioritetet e zhvillimit në secilin prej qarqeve;

16 Objektivat dhe aktivitetet e PKZHQ jepen në figureën e mëposhtme.




0.5 Programi i Zhvillimit të Zonave Jo të Favorizuara (PZHJF)

17 Instrumenti I dyte I Strategjise Ndersektorale per Zhvillimin Rajonal (SNZHR), synon reduktimin e pabarazive ndermjet zonave jo te favorizuara dhe mesatares se Shqiperise duke lehtesuar (mundesuar) aktoret kombetare, rajonale dhe locale per te bere perpjekje bashkepunimi per te rritur potencialin e zhvillimit te ketyre zonave.

18 Tiparet karakteristike te ketij programi jane:

- Nje baze e standartizuar per percaktimin e e dizavantazheve rajonale nepermjet perdorimit te nje modeli te pranuar te nivelit te zhvillimit socio-ekonomik te tyre;
- Percaktimi I zonave jot e favorizuara per nje periudhe 5 vjecare;
- Nje Plan Qeveritar per Zhvillimin e Zonave Jo te Favorizuara dhe alokimi I nje linje te vecante (speciale) buxhetimi per zhvillimin e tyre per te vepruar me skema mbeshtetese speciale si per qarqet ashtu edhe per bashkite/komunat jot e favorizuara.

19 Objektivat dhe aktivitetet e Programit te Zhvillimit te Zonave Jo te Favorizuara paraqiten ne figuren e meposhteme:



0.6 **Kuadri Ligjor per Zhvillimin Rajonal**

20 Nje Ligj mbi Zhvillimin Rajonal do te jete thelbesor per te arritur kohezionin dhe koherencen ne nje fushe nder-sektoriale dhe komplekse, duke kerkuar koordinim domethenes te politikave dhe menaxhimit. Ligji mbi Zhvillimin Rajonal do te rregulloje synimet dhe principet ne lidhje me menaxhimin e zhvillimit rajonal ne Republiken e Shqiperise. Nendarja administrative e Republikes se Shqiperise dhe sistemi qeverisjes rajonale dhe locale, qe formojne nje dimension te rendesishem te kuadrit te politikës rajonale, do te mbeten te pandryshuar nga Ligji I propozuar mbi Zhvillimin Rajonal.

0.7 **Nje kuader Institucional per Zhvillimin Rajonal**

21 Nje numur strukturash consultative dhe zbatuese do te kerkohen ne nivel kombetar dhe rajonal.

22 Keto struktura do te jene:

- Keshilli Kombetar i Partneritetit per Zhvillimin Rajonal, qe do te mbledhe se bashke qeverine qendrore, qeverine rajonale dhe locale dhe partnered sociale dhe shoqerine civile.
- Keshillat e Partneritetit te Qarqeve, qe do te mbledhin se bashku te njejten sere aktoresh – por ne nivel rajonal.
- Departamenti per Zhvillimin e Integruar Rajonal: nje department shume me I zmadhuar Brenda METE, I nevojshem per menaxhimin e politikës rajonale te Shqiperise dhe per zbatimin net e ardhmen te politikës rajonale te BE.

- Agjencia e Zhvillimit te Qarkut: nje structure per menaxhimin dhe zbatimin e strategjise se zhvillimit te qarkut dhe planit te veprimit. Nuk eshte e nevojshme te jete nje strukture e re.

0.8 Implikimi I burimeve

23 Pjesa më e madhe e financimeve për SNZHR do të përfshihen brenda strategjive sektoriale. Kështu, sipas Programit Kombëtar të Zhvillimit të Qarqeve elementi kryesor i financimit është mbështetja financiare nga Qeveria Qendrore për të zbatuar elementet e prioriteteve të investimeve dhe projekteve të të përshkruara brenda Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut dhe të pranuar nëpërmjet Marrëveshjes së Zhvillimit të Qarkut. Mbështetja financiare nga Qeveria Qendrore për të zbatuar elementet e prioriteteve dhe projekteve të investimit të përshkruara brenda Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut, në përgjithësi do të jetë neutrale nga ana e buxhetit; kjo nuk kërkon fonde shtesë, por më tepër një marrëveshje që ministritë e linjës të përdorin një element të buxhetit të tyre ekzistues të investimit kombëtar për të ndihmuar mbështetjen e investimeve të parashikuara në Strategjinë e Zhvillimit të Qarkut dhe të cilat janë në përputhje me prioritetet kombëtare të investimeve.

24 Natyra e investimit të ministrisë së linjës (investim i drejtpërdrejtë, investim i bashkë-financuar me një qark ose bashki/komunë, ose kontroll i deleguar i fondeve në një qark ose bashki/komunë për zbatimin e tyre) do të ndryshojë dhe do të jetë temë e negocimit dhe marrëveshjes ndërmjet ministriesë së linjës, METE dhe Qarkut. Niveli i mbështetjes do të variojë në varësi të klasifikimit të “Shkallës së zhvillimit social-ekonomik” të çdo qarku. Marrëveshja finale do të ratifikohet në një Marrëveshje të Zhvillimit të Qarkut firmosur nga Qeveria dhe Qarku. Këto shuma do të përfshihen brenda buxheteve të strategjive të ndryshme sektoriale.

25 Në mënyrë të ngjashme, pjesa më e madhe e financimeve për veprimet në zonat jo të favorizuara duhet të vijë nga strategjitë sektoriale (duke përfshirë grantin konkurues të komunës/bashkisë).

26 Kërkesat specifike të financimit të SNZHR (që nuk përfshihen në strategjitë sektoriale) lidhen me mbështetjen e qarqeve jot e favorizuara dhe bashkive/komunave jot e favorizuara.

1. Vështrim i Përgjithshëm

1.1 Hyrje

27 Komiteti i Planifikimit Strategjik në Këshillin e Ministrave ka sanksionuar formulimin e një Strategjie Ndersektoriale të Zhvillimit Rajonal (SNZHR) dhe ka caktuar Ministrinë e Ekonomisë që të drejtojë përgatitjen e tij.

28 Qeveria e Shqipërisë ka identifikuar³ nevojën për një politikë të integruar, koherente rajonale bazuar në shqetësimin e saj në rritje për boshllëqet që po thellohen gjithnjë e më shumë në performancën social-ekonomike dhe pasurive ndërmjet pjesëve të ndryshme të vendit. Ndërkohë që Shqipëria kërkon të integrojë plotësisht ekonominë dhe tregjet e saj në kontekstin global dhe, në veçanti në tregun e bashkuar të BE, është shumë e nevojshme të sigurohemi që të gjitha zonat e vendit janë të afta të konkurojnë në këtë treg.

29 SNZHR është menduar si një element kyç i Strategjisë së re Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI)⁴, duke siguruar një metodë të koordinuar në zhvillimin e qëndrueshëm social ekonomik të të gjitha pjesëve të vendit dhe duke lidhur një sere ministrish dhe institucionesh qendrore qeveritare me aktorët dhe institucionet social ekonomike në të gjithë vendin me një përpjekje afat-gjatë bashkërenduar “nga lart poshtë” për të arritur një zhvillim më të ekuilibruar të vendit dhe për të reduktuar mosbarazitë social ekonomike. Si e tille, do të përfaqësojë një tendencë domethënëse ndër-sektoriale dhe të përqëndruar tek rajonet, të SKZHI⁵.

30 Drafti I përgatitur ne Shtator 2007 ka qene subject I konsultimeve intensive me aktoret locale dhe nderkombetare derisa u arrit ne dokumentin actual. Procesi i konsultimit eshte pershkruar ne aneks 1.

1.2 Zhvillimi Rajonal në Shqipëri

1.2.1 Nën-ndarja administrative dhe statistikore e Shqipërisë

31 Ndarja territoriale e Shqipërisë udhëhiqet nga Ligji Nr.. 8652/00 (për organizimin dhe funksionimin e Qeverive Lokale) dhe Ligji 8653/00 (për ndarjen Administrative Territoriale).

32 Ky legjisllacion e ka ndarë vendin në dy nivele: qarqet dhe komunat/bashkitë.

33 Qarqet përfaqësojnë një njësi administrative territoriale me një popullsi mesatare (në 2004) prej 260,605 (shiko hartën më poshtë). Qarqet nën-ndahen në rrethe (por ky i fundit nuk ishte më një nën-ndarje normative të vendit pas kalimit të dy ligjeve që përshkruhen më sipër).

³ Nëpërmjet Programit të Qeverisë të Shtatorit 2005 dhe Strategjisë Kombëtare të saj për Zhvillimin Social-Ekonomik të 2001

⁴ Sistemi i Planifikimit të Integruar, i cili u miratua nëpërmjet Vendimit 692 të Këshillit të Ministrave në Nëntor 2005, vendos kuadrin e planifikimit strategjik. Kjo është përpunuar më tej nëpërmjet: (a) vendimit të Komitetit të Planifikimit Strategjik për planifikimin strategjik (Mars 2006); dhe (b) Udhëzimi për Përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (Maj 2006)

⁵ SNZHR do të jetë një nga dhjetë strategjitë gjithpërfshirëse dhe do të luajë rolin e instrumenteve të koordinimit për zonat prioritare të politikës të cilat nuk janë të përfshira nën çështjet e një ministrie të vetme të linjës.

Nën-ndarja e Shqipërisë në Qarqe



34 Nën-ndarja e mëtejshme e vendit tregohet në tableën e mëposhtme:

Qarku	Rrethi	Qytetet	Bashkitë	Komunat	Fshatrat
Berat	3	5	5	20	245
Dibër	3	7	4	31	280
Durrës	2	6	6	10	106
Elbasan	4	7	7	43	396
Fier	3	6	6	36	278
Gjirokastrë	3	6	6	26	271
Korçë	4	6	6	31	345
Kukës	3	3	3	24	187
Lezhë	3	9	5	16	169
Shkodër	3	6	5	28	272
Tiranë	2	6	5	24	233
Vlora	3	7	7	19	199
Totali	36+1 ⁶	74	65	308	2,980

Burimi: Instituti i Statistikave

35 Këshillat e komunës, bashkisë dhe qarkut janë organet përfaqësuese të qeverive lokale. Komunat dhe bashkitë formohen me përfaqësuesit e zgjedhur direct, ndërsa anëtarët e këshillit të qarkut zgjidhen nga këshillat e komunave dhe bashkive brenda jurisdiksionit të qarkut nga kolegët e tyre në këto këshilla. Kryetarët e bashkive dhe Kryetarët e Këshillave të Komunave janë anëtarë *ex officio*.

36 Këshillat e Qarkut kanë përgjegjësi ligjore për planifikimin dhe koordinimin e veprimeve me interes rajonal (planifikimi i zhvillimit rajonal). Megjithatë, baza e kufizuar e burimeve (fiskale dhe njerëzore) dhe pranimi i kufizuar nga niveli i bashkisë/komunës dhe nga niveli kombëtar nënkuptonte që këshillat e qarkut duhet ende ta përmbushnin këtë rol në mënyrë më efikase

⁶Bashkia e Tiranës klasifikohet gjithashtu si rreth

1.2.2 Pabarazitë Rajonale në Shqipëri

37 Shqipëria ka probleme serioze të pabarazisë rajonale ashtu si tregohet dhe në tabelën e mëposhtme:

Nr	Qarku	Popullsia (numuri) sipas INSTAT	Niveli varferis / Mesatares kombetare %	Niveli I papunesis/ Mesatares kombetare %	Te ardhurat lokale / Mesatares kombetare %	Aksesi furniz. Me uje / Mesatares kombetare %	Niveli I numurit te vizitave mjeksore / Mesatares kombetare %	Plotesimi I arsimit te detyrueshem/ Mesatares kombetare %
1	Berat	181,901	96	99	74.6	114	107	368
2	Dibër	166,367	59	85	61.4	54	70	55
3	Durrës	280,996	102	117	106	131	68	53
4	Elbasan	380,593	80	110	70	83	62	147
5	Fier	380,737	85	133	77	91	83	76
6	Gjirokaster	80,646	131	118	112	97	132	385
7	Korçë	263,586	94	126	78	97	127	202
8	Kukës	102,036	63	42	74	91	56	54
9	Lezhë	159,882	69	61	78	58	89	162
10	Shkodër	250,351	77	52	67	74	120	75
11	Tiranë	677,871	108	168	160	123	140	
12	Vlorë	202,295	139	89	139	132	92	506
	TOTAL	3,127,261						

Burimi: INSTAT INSTAT MPCSSHB MB MPPTT MSH MASH


38 Pabarazia rajonale eshte prezente ne orme ekstreme ne Shqiperi: Varferia eshte 66% me e larte ne zonat rurale se ne Tirane dhe 50% me e larte se ne qendrat e tjera kryesore urbane. Tirana ka nje indeks te PBB prej 0.772 perkundrejt nje indeksi te PBB prej 0.252 te nje pjese te zonave malore dhe nje indeks te zhvillimit njerezor 0.830 perkundrejt nje indeksi prej 0.632 te zonave malore.

39 Pabarazite paraqiten ekstreme: p.sh. niveli I papunesise ne Kukës eshte mbi tre here me I larte se ne Tirane, niveli I varferise ne Kukës eshte mbi dy here me I larte se ne Vlore, popullsia ne Vlore kane dy here me teper akses ne furnizimin me uje te pijshem se ata ne Diber, banoret e Tiranës kane 2,5 here me teper akses ne drejtim te vizitave mjeksore se ata ne Kukës.

40 Migrimi i brendshem rezulton me pabarazi te brendeshme masive: ndermjet viteve 2005 dhe 2006 popullsia e Tiranës eshte rritur me 137,000 dhe ajo e Durresit me 43,000 banore, ndersa popullsia e Dibres paksohet me 43,000 (nje reduktim prej 23% e popullsise se Qarkut) dhe ajo e Kukësit me 30,000 (nje reduktim 27% e popullsise se Qarkut)

41 Matja e dizavantazheve ne nivel rrethi tregon se pabarazia rajonale eshte pabarazisht e shperndare edhe brenda qarkut. I njejt model i shperndarjes se pabarazise paraqitet edhe ne nivel komune brenda te njejt rreth, duke demonstruar se ekzistojne komuna te pa favorizuara brenda qarqeve me te pafavorizuara.

Raporti I nivelit te varferise te Komunave me nivelin e varferise te Rretheve



Commune Level HDC Estimates Compared to District Level HDC Estimates

- Significantly less poor than District Level mean
- No Statistically Significant Difference
- Significantly poorer than District Level mean

Burimi: Harta e Varfërisë dhe Pabarazisë në Shqipëri, Banka Botërore, Qershor 2003

1.2.3 *Instrumentet ekzistuese për të zgjidhur pabarazinë rajonale*

42 Sistemi i Qeverisë për transfertat e pakushtëzuara financiare tek komunat dhe bashkitë për të financuar pjesërisht shpenzimet e tyre kërkon të mari në konsiderate disavantazhet rajonale si bazë të llogaritjes. Baza e llogaritjes së grantit është komplekse dhe bazohet kryesisht tek popullsia, por lë hapësira për mbështetje të vacantë ndaj:

- Komunave dhe bashkive baza e taksave të të cilave (mbi bizneset e vogla dhe regjistrimin e automjeteve) është shumë më e ulët se mesatarja kombëtare që do të kompesohet me transfertat nga ato komuna dhe bashki baza e taksës së të cilave ishte shumë më e lartë se mesatarja kombëtare (barazimi fiskal).
- Mbështetje tranzitore për ato komuna dhe bashki baza e taksës së të cilave ishte më e ulët se viti i mëparshëm nga transfertat nga të tjerët ku baza e taksës së të cilëve ishte më e lartë se viti i mëparshëm (rregullimi tranzitor).
- Të ardhura minimale të garantuara për kokë për komunat dhe bashkitë (1900 Lek/kokë për komunat dhe 2900 Lek/kokë për bashkitë në 2006).
- Një koeficient i drejte, i cili synon të sigurojë që bashkitë dhe komunat të cilat kanë marrë investime më të ulta se mesatarja për rrugët gjatë katër viteve të mëparshme do të kompesohen.
- Komunat/bashkitë e vendosura në zonat malore janë kompesuar.
- Bashkive në nevojë u jepet gjithashtu kompesim i vecantë.

43 Mbështetja e Qeverisë ndaj qarqeve bazohet gjithashtu kryesisht në popullsinë, por ka një koeficient gjeografik i cili synon në sigurimin e mbështetjes së vacantë nëse qarku është kodrinor ose malor.

2. Vizioni, prioritetet dhe qëllimet

2.1 Vizioni

44 Deklarata e vizionit të Qeverisë për SNZHR është: “Një rritje e ekuilibruar dhe e qëndrueshme social-ekonomike në rajonet e Shqipërisë, në përgjithësi, dhe zonat malore dhe periferike, në veçanti, me qëllim që të mbështesi një zhvillim të shpejtë të të gjithë vendit dhe të përshpejtojë proceset e integritimit në BE dhe NATO”.

45 Ky vizion specifikohet më tej në qëllime, objektiva dhe prioritete strategjike.

2.2 Qëllimet

46 Qëllimet e SNZHR janë:


- Reduktimi i pabarazisë aktuale të zhvillimit ndërmjet rajoneve;
- Rigjallërimi i zonave tepër të pafavorizuara (ato që janë të izoluara nga proceset kryesore të zhvillimit)
- Parandalimi i situatave emergjente të cilat mund të vijnë nga shembujt e rinj të zhvillimit të paekuilibruar
- Krijimi i platformës politike dhe ligjore me bazë të gjerë për një zhvillim të qëndrueshëm të rajoneve, gjë që do të parandalojë shtrembërimin dhe politikat preferenciale në çështjet që lidhen me zhvillimin ekonomik dhe social të rajoneve

2.3 Objektivat Strategjike

47 Qëllimet do të arrihen nëpërmjet dy objektivave strategjike: objektivi i parë strategjik synon që të sigurojë që të gjitha qarqet të jenë në gjendje të kontribuojnë në zhvillimin dhe konkurrencën e qëndrueshme – dhe në këtë mënyrë të reduktojnë pabarazitë sociale dhe ekonomike në të gjithë vendin

48 Objektivi i dytë strategjik synon në krijimin e një kuadri efikas të menaxhimit për zhvillimin rajonal.

Strategjia: Vizioni, objektivat, dhe prioritetet



2.3.1 *Objektivi Strategjik 1: Të gjitha qarqet mundësohen të kontribuojnë në zhvillimin dhe konkurrencën e qëndrueshme në Shqipëri*

49 Ky objektivi do të arrihet duke iu referuar dy prioriteteve kryesore:

- Forcimi i kapacitetit të zhvillimit të qarqeve në të gjithë vendin për të përdorur dhe menaxhuar potencialin e tyre të zhvillimit
- Mbështetja e zonave jo të favorizuara për të kontribuar në zhvillimin dhe konkurrencën e qëndrueshme kombëtare

Prioriteti 1.1: Forcimi i kapacitetit të zhvillimit të qarqeve në të gjithë vendin për të përdorur dhe menaxhuar potencialin e tyre të zhvillimit

50 Planet e Zhvillimit Rajonal janë përgatitur tashmë për disa rajone individuale të Shqipërisë. Këto s'janë zbatuar asnjëherë pjesërisht pasi nuk u vendos anjëherë një partneritet efikas i zhvillimit ndërmjet niveleve qendrore dhe rajonale. Planet e Zhvillimit Rajonal nuk ishin të lidhura me planifikimin e zhvillimit kombëtar ose me procesin e buxhetimit, prandaj dhe u pane si periferike; zbatimi ka qenë i kufizuar. Ekziston nevoja që qeveria qendrore të mobilizojë dhe të hyjë në një partneritet të ri të zhvillimit me aktorët social-ekonomik në nivelet e qarkut dhe ndër-qarkor. Ky partneritet i ri do të bazohet në një dokument të ri të planifikimit – Strategjia e Zhvillimit të Qarkut (SZHQ). SZHQ do të jetë dokumenti kryesor i planifikimit për zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik të çdo qarku. Plani i veprimit të SZHQ do të jetë dokumenti i detajuar operacional që lejon zbatimin e SZHQ. Objektivat e Zhvillimit të Qarkut do të jenë:

- Të veprojnë si një marrëveshje konsensusi ndërmjet të gjithë pjesëmarrësve përkatës kombëtarë, të qarkut, bashkisë dhe komunës për sa i përket nevojave të qarkut për zhvillim (në lidhje me zhvillimin ekonomik, punësimin dhe trajnimin, nevojat e infrastrukturës, mjedisin, zhvillimin local, urban dhe rural, duke trajtuar varfërinë dhe përjashtimin social) dhe në këtë mënyrë të sigurohet baza për negociimin, harmonizimin dhe financimin e aktiviteteve të përcaktuara brenda strategjisë.
- Të trajtojnë objektivat strategjike të përbashkëta me qarqet fqinje si dhe, aty ku është e mundur, nevojat dhe mundësitë ndër-kufitare dhe ndër-rajonale.
- Të sigurojnë udhëzimet bazë për planet dhe projektet e zhvillimit local të bashkive dhe komunave të cilat përfshihen tek qarku.

51 Qeveria do të përgatisi “Udhëzimet Kombëtare për përgatitjen e SZHQ”: Këto do të sigurojnë kontekstin më të gjerë të politikës dhe procedurat për përpunimin e SZHQ, duke specifikuar gjithashtu dhe temat prioritare të zhvillimit kombëtar dhe të BE. Brenda këtij kuadri çdo SZHQ (dhe Plani shoqëruar i Veprimit) do të kërkohet të ketë një structure të detyrueshme dhe të jetë subject i vlerësimit *ex ante* (i cili do të kërkojë të sigurohet se Udhëzimet Kombëtare ndiqen, që buxheti është realist në lidhje me buxhetin kombëtar, buxhetin e qarkut dhe buxhetet bashkiake dhe se afatet kohore për zbatimin janë gjithashtu realiste).

52 Pasi të arrihet marrëveshja ndërmjet të gjitha palëve për Planin e Veprimit që do të financohet, atëherë kjo do të zyrtarizohet nëpërmjet një “marrëveshjeje të partneritetit të qarkut” firmosur nga të njëjtat pale të cilat angazhohen për investimet për të cilat është rënë dakort.

Instrumenti i Politikës

53 Instrumentet për këtë prioritet janë *Programi i Zhvillimit të Qarkut*. Ky përcaktohet në Kapitullin 3.

Prioriteti 1.2: Mbështetja e zonave jo të favorizuara për të kontribuar në zhvillimin dhe konkurrencën e qëndrueshme kombëtare

54 Modelet ekzistuese të zhvillimeve të dështuara janë pasojë e faktorëve të shumtë dhe shpesh të ndërthurur me njëri tjetrin.

55 Paaftësia për të zgjidhur disa defekte gjeografike natyrore, siç është për shembull largësia, terreni kodrinor ose malor dhe burimet e varfëra natyrore ka patur një ndikim shkatërrues në jetën e gjallë lokale, në biznesin e vogël dhe në perspektivën e zhvillimit në përgjithësi. Shumë zona kanë qenë dëshmitare të zvogëlimit në maksimum të mundësive për punësim pasi dhe pjesa më e madhe e më të kualifikuarve kanë zgjedhur të shkojnë në Tiranë ose jashtë vendit, duke krijuar një cikël negativ të profesionalizmit në rënie dhe rrallimit të aftësive.

56 Po kështu, tranzicioni prej shumë dekadash i planifikimit të centralizuar drejt një ekonomie tregu konkurrese globalisht ka pasur një ndikim shumë negativ në lidhje me aktivitetin ekonomik, punësimin dhe të ardhurat në pjesën më të madhe të zonave më pak të zhvilluara të vendit. Disa ekonomi locale, të cilat më pare drejtoheshin nga konglomeratet e mëdha shtetërore, ende duhet të përballen pashmangshmërisht me përshtatjen, rritjen e papunësisë me shifra të larta, produktivitetin e ulët, të ardhurat e pakta dhe një kulturë varësie.

57 Metoda e propozuar ka të bëjë me prezantimin e një sere veçorive novatore për trajtimin e problemeve të zonave jo të favorizuara në Shqipëri:

- NJë model i thjeshtë i cili siguron një profil të vetëm jo të shumfishtë të disavantazhit social ekonomik si një sistem për synime më të mira;
- Përcaktimi i disavantazheve në nivelet e ndryshme rajonale;
- Mbështetja e shtetit për zonat e përcaktuara lidhet me përpjekjet për zhvillim në nivelin e qarkut, jo si një ndihmë apo si një fond shtesë për mbulimin e nevojave rutinë, por duke trajtuar në mënyrë aktive shkaqet e disavantazheve.

Instrumenti i Politikës

58 Instrumenti i zhvillimit për këtë prioritet do të jetë *Programi i Zhvillimit të Zonave Jo të Favorizuara* i cili synon të trajtojë nevojat për zhvillim të atyre zonave në Shqipëri të cilat janë përcaktuar të jenë vazhdimisht nën mesataren e vendit. Zonat jo të favorizuara janë ato të cilat janë përcaktuar si jo të favorizuara, të cilat plotësojnë disa kritere specifike ekonomike, infrastrukurore, sociale dhe demografike të gjendjes së prapambetur.

59 Programi Zhvillimit të Zonave Jo të Favorizuara paraqitet në Kapitullin 3.

2.3.2 Objektivi Strategjik 2: Një kuadër eficient i menaxhimit për zhvillimin rajonal

60 Objektivi i dytë i Strategjisë vjen nga nevoja për një kuadër të unifikuar ligjor e coherent dhe një infrastrukturë institucionale, efikase dhe e koordinuar për politikën rajonale. Ky objektivi do të ketë efekt në çdo pjesë të realizimit të priprimit sipas Objektivit Strategjik 1.

61 Sipas këtij objektivi ka dy prioritete:

- Krijimi i një kuadri të nevojshëm ligjor për menaxhimin efikas të politikës rajonale;
- Krijimi i një kuadri institucional për menaxhimin efikas dhe zbatimin e politikës rajonale në të gjitha nivelet.

Prioriteti 2.1: Të krijohet kuadri ligjor për menaxhimin efikas të politikës rajonale

62 Qëllimi i këtij prioriteti është krijimi i një kuadri ligjor coherent e të integruar për zhvillimin rajonal i cili përshtat, koordinon dhe rifokuson ligjet ekzistuese për zonat specifike dhe ato që rregullojnë marrëdhënien ndërmjet niveleve qendrore, të qarkut dhe bashkisë/komunës të qeverisjes. Kuadri i ri ligjor do të mbështesë prezantimin e instrumenteve të reja të zhvillimit për zhvillimin e qëndrueshëm rajonal.

63 Politika efikase e zhvillimit rajonal ka nevojë për një strukturë ligjore të unifikuar e cila siguron drejtim të qartë për politikë-bërësit dhe mundëson veprimet e mundshme të nevojshme në nivel kombëtar dhe rajonal.

Instrumenti i Politikës

64 Instrumenti për të realizuar këtë prioritet është *Ligji i propozuar për Zhvillimin Rajonal* si një bazë për zhvillimin dhe zbatimin e politikës, duke mbuluar çështjet e menaxhimit, duke dhënë përkufizime dhe parime koherente si dhe bazën ligjore për një kuadër institucional dhe të menaxhimit. Një strukturë e kuadrit të propozuar ligjor jepet në Kapitullin 3.

Prioriteti 2.2: të sigurohet kuadri institucional për menaxhimin dhe zbatimin efikas të politikës rajonale në të gjitha nivelet

65 Qëllimi i këtij prioriteti është të përmirësojë rregullimet institucionale në nivelin kombëtar, të cilat do të jenë të nevojshme për koordinimin, administrimin dhe menaxhimin efikas të politikës rajonale.

66 Shume institucione janë përfshirë aktualisht në zbatimin e programeve të qeverisë, të cilat shpesh sillen rreth të njëjtës gjë dhe janë të pakoordinuar. Politika efikase rajonale kërkon koordinimin e ndërhyrjeve. Ka një nevojë për një përcaktim të qartë të roleve dhe përgjegjësisë dhe për një bazë më të fortë institucionale për koordinimin ndër-ministor në krahasim me gjendjen e tanishme.

67 Përgatitja, zbatimi dhe menaxhimi i politikës rajonale kërkon aftësi dhe sisteme të lidhura me ciklin e jetës së politikës (programimin, planifikimin strategjik dhe menaxhimin) dhe sisteme për monitorimin e rezultateve dhe ndikimin. Përvetësimi i aftësive dhe zhvillimi i sistemeve janë çështje të rëndësishme në vetvete dhe para-kushte për zbatimin e programeve të financuara nga BE si para ashtu dhe mbrapa pranimin në BE.

Instrumenti i Politikës

68 SNZHR përfshin riorganizimin dhe forcimin e rregullimeve institucionale për menaxhimin, koordinimin dhe realizimin e integruar rajonal. Kjo do të arrihet nëpërmjet një serie veprimesh në

periudhën afat-shkurter, afat-mesme dhe afat-gjatë, duke synuar në përmirësimin dhe forcimin e regullimeve institucionale në nivelin kombëtar, duke përfshirë ato për konsultim dhe partneritet (shiko Kapitullin 3).

3. Politikat

3.1 Programi i Zhvillimit të Qarkut (PZHQ)


69 Qëllimi i këtij programi është të lehtësojë krijimin e një sistemi të vetëm të zhvillimit ta planifikimit dhe menaxhimit rajonal ne vend. Programi forcon kapacitetin për menaxhimin e zhvillimit dhe përmirëson thithjen e fondeve publike nëpërmjet një koordinimi më të mire dhe integritit të ndërhyrjeve për zhvillim dhe shërbimeve në nivelin e qarkut dhe atë lokal.

70 PZHQ prezanton një grup elementesh të rinj në politikën rajonale të Shqipërisë:

- Një kuadër të vetëm të politikës për zhvillimin social-ekonomik të qarqeve, duke marrë parasysh nevojat e tyre specifike për zhvillim;
- Partneriteti ndërmjet pjesmarrësve kombëtarë, të qarkut, të bashkisë dhe komunës;
- NJë dokument i vetëm i programimit të zhvillimit social-ekonomik për qarkun – Strategjia e Zhvillimit të Qarkut – dhe një agjenci e vetme lokale për të koordinuar zbatimin e saj – Agjencia e Zhvillimit të Qarkut.
- Koncepti i “marrëveshjes për zhvillimin e qarkut”: një plan financiar, operacional dhe strategjik shumë-vjeçar i cili parashtron mbështetjen e qeverisë qendrore për prioritetet e zhvillimit në secilin prej qarqeve;
- Sisteme efikase të monitorimit, vlerësimit dhe raportimit.

Objektivat dhe aktivitetet

71 Objektivat dhe aktivitetet e PZHQ jepen në figurën e mëposhtme.



Objektivi 1: Një kuadër kombëtar i zhvillimit rajonal për qeverinë qendrore dhe qarqet

72 Objektivi i parë i PZHQ është të krijojë një kuadër kombëtar për zhvillimin rajonal brenda të cilit qeveria qendrore dhe pjesmarrësit e zhvillimit në nivelin e qarkut punojnë së bashku për të realizuar qëllimet e përbashkëta të zhvillimit.

73 Programi siguron një kuadër të përbashkët të zhvillimit Brenda të cilit politika qendrore dhe menaxherët e programit, në bashkëpunim me institucionet me bazë qarku duke përfshirë të gjithë grupet social-ekonomike, mund të kontribuojnë në përcaktimin e drejtimeve të qarta të politikës për zhvillimin në nivelin e qarkut.

Aktiviteti 1: Përgatitja e udhëzimeve kombëtare

74 Aktiviteti kryesor sipas këtij objekti është përgatitja e një numri *udhëzimesh kombëtare* strategjike e cila do të bënte të mundur që të gjithë pjesmarrësit përkatës në qarqe/rajone të bashkërendisin nevojat locale me prioritetet kombëtare social-ekonomike.

75 Udhëzimet strategjike kombëtare do të inkurajojnë Këshillat e Partneritetit të Qarqeve në përgatitjen e strategjive të tyre për zhvillimin e qarqeve duke marrë parasysh nevojat për zhvillim brenda kufijve të qarkut – infrastruktura sociale, ekonomike, mjedisore, fizike – në përputhje me të gjitha prioritetet kombëtare të zhvillimit. Ato do ta vendosin fokusin përfundimisht mbi prioritetet e përcaktuara në Këshillat e Lisbonës dhe Gothenburgut – duke rrënjësuar një kulturë zhvillimi që nxit konkurrencën, inovacionin dhe punësimin. Lidhja me prioritetet kombëtare të zhvillimit të Shqipërisë do të bëhet nëpërmjet një lidhjeje të qartë me dokumentet Shqiptare të planifikimit të zhvillimit dhe me Fondet Strukturore të BE duke iu referuar përdorimit të planifikuar të Shqipërisë të instrumentit për Para-Pranim.

76 Gjithashtu udhëzimet kombëtare do të parashtrajnë dhe qëllimin e strategjisë së zhvillimit të qarkut duke përfshirë dhe nevojat për zhvillim të zonave jo të favorizuara brenda kufijve të qarkut si dhe temat e

interesit kombëtar (si për shembull mbrojtja e mjedisit, qëndrueshmëria dhe barazia). Strategjitë e zhvillimit të qarkut do të përfshijnë një kapitull mbi nevojat e zhvillimit ndër-kufitar dhe ndër-qarkor.

77 Udhëzimet kombëtare do të përfshijnë si elemente kryesore:

- Qëllimet dhe synimet e plota të zhvillimit për PZHQ
- Rolet, përgjegjësitë dhe mardhëniet e palëve të ndryshme ndaj kuadrit
- Qëllimi, hapësira që mbulohet dhe struktura e strategjive të zhvillimit të qarkut
- Rregullimet për menaxhimin e PZHQ dhe për asistencë financiare

Aktiviteti 2: Duke përfshirë qeverinë qendrore, qarkun dhe bashkinë/komunën dhe pjesmarrësit e zhvillimit

78 Udhëzimet kombëtare draft do të shqyrtohen dhe nga Këshilli Kombëtar i Partneritetit për Zhvillimin Rajonal para se të kalohen në Qeveri për miratim. Kjo do të sigurojë që këto udhëzime janë diskutuar gjerësisht nga pjesmarrësit në të gjitha nivelet para miratimit.

79 Udhëzimet kombëtare do të përpunohen deri sa të jenë të përshtatshme për ciklin buxhetor të Qeverisë dhe periudhën e SNZHR dhe do të rishqyrtohen çdo vit me një raport drejtuar Qeverisë.

Objektivi 2: Kapaciteti i forcuar i zhvillimit në nivelin e Qarkut

80 Objektivi i dytë është të ndërtohet dhe të forcohet kapaciteti i menaxhimit në nivelin e qarkut i cili është i nevojshëm për të mundur që të gjitha qarqet dhe rajonet më të gjera të merren si duhet me sfidat e zhvillimit në të ardhmen, me ndryshimet dhe shokimin që vjen nga jashtë.

Aktiviteti 1: Krijimi i partneriteteve të cilat do të kontribuojnë në përgatitjen e strategjisë të zhvillimit të qarkut në të gjitha qarqet

81 Këshillat e Partneritetit të Qarkut do të përfshijnë përfaqësuesit të cilët do të kenë secili nga një rol të vetin, si dhe influenceën e tyre në procesin e zhvillimit rajonal; këta do të krijohen nga:

- Të gjitha organet përkatëse shtetërore që punojnë në nivelin e qarkut;
- Këshillat e Qarkut;
- Këshillat e Komunës dhe Bashkisë;
- Partnerët socialë dhe bizneset si dhe sindikatat në nivelin e qarkut;
- Organizatat e shoqërisë civile (d.m.th OJQ-të).

82 Gjatë krijimit të poartneriteteve, ka disa faktorë të cilët janë vendimtarë në arritjen e suksesit. Së pari, do të duhet kohë – dhe pak mbështetje – që Këshillat e Partneritetit të Qarkut të zhvillojnë normat dhe vlerat e përbashkëta të punës të cilat janë thelbësore për partneritetet funksionale. Së dyti, aftësitë e anëtarëve të partneritetit duhet të zhvillohen më tej, duke kërkuar trajnime dhe asistencë teknike.

Aktiviteti 2: Krijimi i një Agjencie për Zhvillimin e Qarkut (AZHQ) brenda çdo qarku.

83 AZHQ-të do të mbështesin Këshillat e Partneritetit të Qarkut të tyre. Agjencia e Zhvillimit të Qarkut përfaqëson një ekip shumë-disiplinor i cili nxit dhe mbështet përpjekjet e zhvillimit në të gjithë qarkun.

AZHQ do të ndihmojë Këshillin e Partneritetit të Qarkut në punën e tij, do të ndërmarri kërkime, do të lehtësoje konsultimet me grupet locale të interesit, do të përgatisin dokumente strategjike dhe do të sigurojnë mbështetje në zbatimin e Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut.

84 Keshilli I Qarkut do te vendose, mbeshtetur ne autoritetin e tij, duke diskutuar ne vazhdim me Keshillin e Partneritetit te Qarkut, nese AZHQ do te duhet te bazohet ne Departamentin ekzistues te Programim-Zhvillimit Brenda struktures se Keshillit te Qarkut, nje strukture alternative tashme e formuar ne nivel qarku, ose do te jete nje structure e re. Ne marrjen e vendimit per sa I perket natyres se AZHQ, Keshilli I Qarkut do te nevojitet te konsideroje me kujdes persa I perket structures qe eshte me e pranueshme te sjelle mbeshtetje (si morale dhe financiare) nga aktoret e tjere locale dhe nga donatoret e huaj. Ne se AZHQ eshte formuar si nje departament I Keshillit te Qarkut dhe pastaj do te formohet legalisht nga Keshilli I Qarkut dhe do te pergjigjet ligjerisht parpara tij, Keshilli I Qarkut mund te doje te perfshije aktore te tjere kyc te qarkut ne bordin e tij te drejtoveve.

85 Keshilli I Qarkut do te duhet te vendose per marredheniet ndermjet AZHQ dhe cdo agjencie zhvillimi ekzistuese ne nivel qarku, por do te duhet te jete e qarte se ne nje qark mund te jete vetem nje AZHQ e njohur.

86 Do te duhej te ishte e qarte se institucionalisht ka opsione te ndryshme per strukturen dhe natyren e AZHQ, por secila do te duhej te akreditohej formalisht nga Qeveria, perpara se te njihej si nje AZHQ.

Faktoret kryesore qe Qeveria do te konsideroje jane qe: (a) ajo te jete e vetmja structure per kete qellim per Keshillin e Qarkut ne fjale; (b) te veproje mbi bazen e nje organizate jo fitim prures; (c) te jete e vetmja strukture vepruese ne qerkun ne fjale ; and (d) te plotesoje kriteret e akreditimit te vendosura nga METE.

Objektivi 3: Strategjitë e zbatuara për qarqet dhe rajonet më të gjera

87 Objektivi i tretë i PZHQ është përgatitja e një Strategjie të Zhvillimit të Qarkut (SZHQ) e cila të jetë koherente, e integruar dhe e bazuar tek nevojat për zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik të çdo qarku bazuar në pjesmarrjen e plotë të të gjithë pjesmarrësve përkatës të zhvillimit në atë nivel. Baza e mundshme për SZHQ tregohet në aneksin 3.

Aktiviteti 1: Përgatitja e Strategjive të Zhvillimit të Qarkut

Udhëzimet Kombëtare do të sigurojnë kontekstin më të gjerë dhe procedurat e politikës për përpunimin e SZHQ, duke specifikuar gjithashtu dhe temat prioritare të zhvillimit në nivel kombëtar dhe ato të BE. Strategjia e Zhvillimit të Qarkut do të trajtojë nevojat për zhvillim të qarkut (zhvillimin ekonomik, punësimin dhe trajnimin, nevojat e infrastrukturës, mjedisin, zhvillimin lokal, urban dhe rural, duke trajtuar varfërinë dhe përjashtimin social) dhe do të kërkojë pjesmarrjen aktive të shumë grupeve të ndryshme të interesit. Gjithashtu do të trajtojë dhe objektivat e përbashkëta strategjike me qarqet e tjera fqinje si dhe nevojat dhe mundësitë ndër-kufitare dhe ndër-rajonale. Çdo SZHQ do t'i kërkohet të ketë kapituj të detyrueshëm që mbulojnë sa më poshtë:

- Nevojat social-ekonomike të qarkut, duke përfshirë qytete më të mëdha;
- Nevojat e zonave jo të favorizuara;
- Prioritetet ndër-kufitare dhe ndër-rajonale;

- Integrimi me planet e zhvillimit lokal (aty ku ekzistojnë).

88 Strategjia e Zhvillimit të Qarkut do të përgatitet mbështetur në cdo Strategji Rajonale Zhvillimi ekzistuese ose dokument tjetër planifikimi lokal dhe nuk do të përgatitet e izoluar krejtësisht prej tyre.

89 Bashkëpunimi ndërmjet rajoneve do të mbështetet nëpërmjet inkurajimit të **“Projekteve të Përbashkëta të Zhvillimit”** i cili do të identifikohet në SZHQ të qarqeve, që dëshirojnë të bashkëpunojnë me njëri tjetrin. “Projekte të tilla të Zhvillimit të Përbashkët” do të inkurajohen nëpërmjet shpërndarjes në rritje të financimeve, kërkesave të reduktuara të bashkë-financimit dhe ponderimi selektiv.

90 SZHQ do të negociohet me institucionet e qeverisë qendrore për sa i përket proriteteve dhe projekteve të investimit të cilat do të financohen nga qeveria qendrore për realizimin e strategjisë. Kjo marrëveshje do të parashtrohet në një **Marrëveshje e Zhvillimit të Qarkut** ndërmjet Qarkut dhe Qeverisë Qendrore.


91 Shkalla e zhvillimit social-ekonomik të një qarku do të merret gjithashtu në considerate nga institucionet e qeverisë qendrore duke vendosur bazën e mbështetjes së tyre financiare nëpërmjet Marrëveshjes së Zhvillimit të Qarkut.

3.2 Programi i Zhvillimit të Zonave Jo të Favorizuara (PZHJF)

92 Instrumenti i dytë i Strategjisë është Programi i Zhvillimit të Zonave Jo të Favorizuara (PZHJF), duke synuar në eliminimin e pabarazive ndërmjet zonave jo të favorizuara dhe mesatares Shqiptare duke mundësuar që aktorët kombëtarë, rajonalë dhe lokale të bëjnë përpjekje bashkëpunimi për të maksimizuar potencialin e zhvillimit të atyre zonave.

Objektivat dhe aktivitetet

93 Objektivat dhe aktivitetet e PZHJF jepen në figurën e mëposhtme:



Vleresimi i dizavantazhit.

94 Vlerësimi i nivelit të zhvillimit socio-ekonomik do të bazohet në vlerat e një indeksi të nivelit të zhvillimit social-ekonomik. Ky do të bazohet mbi llogaritjen e menduar të disa treguesve. Keta do të jënë:

Indikatori	Pesha ne (%)	Burimi
Niveli i varferise / mesatares kombetare	20	INSTAT
Niveli i papunesise / mesatares kombetare	20	MPCSSHB
Te ardhurat lokale / mesatares kombetare	10	MB
Niveli i aksesit ne furniz. me uje / mesatares kombetare	15	MPPTT
Numuri I vizitave mjeksore / mesatares kombetare	10	MSH
Niveli I arsimimit te detyrueshem / mesatares kombetare	10	MASH

95 Bashkite dhe komunat do te klasifikohen ne baze te indeksit te nivelit te tyre te varferise. Fillimisht ai do te jete ashtu sic eshte percaktuar nga INSTAT ne raportin e tij te vitit 2004 „ Harta e Varferise dhe Pabarazise ne Shqiperi“

96 Nje model vleresimi I “Shkalles se Zhvillimit Socio-Ekonomik” eshte zhvilluar per te lejuar nje kategorizim te qarte te qarqeve, rretheve, bashkive/komunave lidhur me nivelin e zhvillimit socio-ekonomik te tyre.

97 Objektivi primar I modelit te ri eshte matja objective e diferencave social-ekonomike ndermjet njesive territoriale.

98 Sipas ketij modeli kriteri baze per kategorizimin e qarqeve ne lidhje me shkallen e zhvillimit socio-ekonomik te qarqeve do te jete:

Kategorizimi i Qarqeve	Kriteri
Kategoria I	- Qarqe me një vlerë indeksi të zhvillimit social-ekonomik nën 50% të mesatares kombëtare
Kategoria II	- Qarqe me një vlerë indeksi të zhvillimit social-ekonomik ndërmjet 50% dhe 75% të mesatares kombëtare
Kategoria III	- Qarqet me një vlerë indeksi të zhvillimit social-ekonomik ndërmjet 75% dhe 100% të mesatares kombëtare
Kategoria IV	Qarqet me një vlerë indeksi të zhvillimit social-ekonomik ndërmjet 100% dhe 125% të mesatares kombëtare
Kategoria V	Qarqe me vlerë të indeksit të zhvillimit social-ekonomik mbi 125% të mesatares kombëtare

99 Nje indikator I shtate, “levizja e popullsisë ne raport me mesataren kombetare” do te perdoret per qarqet, per te konfirmuar perfshirjen ne kategorine II apo III tea tyre qarqeve qe rezultojne ne nivelet e klasifikimit prane 75%.

100 Bashkitedhe komunat mund të klasifikohen si me poshte:

Kategorizimi I bashkive/komunave	Kriteri
Kategoria I	- Bashkitë/komunat me një vlerë indeksi të zhvillimit social-ekonomik nën 50% të mesatares kombëtare
Kategoria II	- Bashkitë/komunat me një vlerë indeksi të zhvillimit social-ekonomik ndërmjet 50% dhe 75% të mesatares kombëtare
Kategoria III	- Bashkitë/komunat me një vlerë indeksi të zhvillimit social-ekonomik ndërmjet 75% dhe 100% të mesatares kombëtare
Kategoria IV	- Bashkitë/komunat me një vlerë indeksi të zhvillimit social-ekonomik ndërmjet 100% dhe 125% të mesatares kombëtare
Kategoria V	- Bashkitë/komunat me një vlerë indeksi të zhvillimit social-ekonomik mbi 125% të mesatares kombëtare

Objektivi 1: Plani i Integruar i Zbatuar i Qeverisë për Zhvillimin e Zonave Jo të Favorizuara

101 Objektivi i pare është krijimi i një kuadri të integruar të politikës kombëtare me një focus ekskluziv mbi eliminimin e disavantazheve dhe pabarazive dhe përgatitja dhe zbatimi i një Plani të Integruar të Qeverisë për Zhvillimin e Zonave Jo të Favorizuara. Aktivitetet fillestare sipas këtij objekti janë:

- Përcaktimi i zonave jo të favorizuara për një periudhë kohe prej 5 vjetësh.
- Zhvillimi, zbatimi dhe monitorimi i Planit të Qeverisë për Zhvillimin e Zonave Jo të Favorizuara dhe shpërndarjen e linjës së vecantë të buxhetit për Zhvillimin e Zonave Jo të Favorizuara.

Aktiviteti 1: Përcaktimi i zonave jo të favorizuara për një periudhë prej 5 vjetësh

102 Zonat jo të favorizuara do të përcaktohen për një periudhë prej 5 vjetësh. Përcaktimi do të vlerësohet në Vitin 5 të periudhës 5 vjeçare për të vendosur nëse zonat duhet të shtohen apo të hiqen nga zonat e përcaktuara në periudhën e mëpasshme 5 vjeçare. Zonat të cilat janë vendosur nëpërmjet vlerësimit të Vitit 5 që do të hiqen nga lista e zonave të përcaktuara si jo të favorizuara do të vazhdojnë të trajtohen me statusin e mëparshëm të disavantazhit për vitin e parë të periudhës së mëpasshme 5 vjeçare.

103 Zonat jo të favorizuara do të jenë:

- Qarqet e përcaktuar në Kategorinë 1 ose 2 duke përdorur modelin e vlerësimit.
- Bashkitë dhe komunat e përcaktuara në Kategorinë 1 dhe 2 duke përdorur mënyrën e vlerësimit.

Aktiviteti 2: Plani i Qeverisë për Zhvillimin e Zonave Jo të Favorizuara

104 Plani i Qeverisë për Zhvillimin e Zonave Jo të Favorizuara do t'i trajtojë disavantazhet në dy nivele të veçanta:

- Qarqet jo të favorizuara – ku do të trajtohen çështjet e mëdha që lidhen me kohezionin social-ekonomik. Qëllimi do të jetë arritja e objektivave të politikës kombëtare nëpërmjet impaktit në nivelin e qarkut.
- Bashkitë dhe komunat jo të favorizuara – ku do të trajtohen zonat individuale të disavantazheve brenda qarqeve. Qëllimi do të jetë që të arrihen objektivat e politikës së qarkut nëpërmjet impaktit në nivelin e bashkisë/komunës.

Mbështetja e qarqeve të pafavorizuara

105 Mbështetja do të marrë formën e një “fondi shtesë” që sigurohet nga Qeveria nga buxheti për buxhetin e Programit të Zhvillimit të Zonave Jo të Favorizuara në shkëmbim të një marrëveshjeje nga ministritë e linjës në zonat e zhvillimit ekonomik, zhvillimit të burimeve njerëzore dhe infrastructures për të:

- Përshtatur masat e tyre ekzistuese (ponderimi dhe bashkë-financimi) ose prezantimin e masave të reja të cilat do të favorizonin aplikimet për mbështetje të marra nga qarqet jo të favorizuara dhe që do të çojnë në zvogëlimin e pabarazisë rajonale.
- Caktuar një shumë të negociuar nga i gjithë buxheti i tyre kombëtar për masa specifike që do të përdoren për aplikimet e miratuara nga qarqet jo të favorizuara.

106 Masat ekzistuese do të rregullohen dhe masat e reja do të përgatiten nga Ministritë e Linjës nëpërmjet procesit të negociimit me Departamentin e Programimit Strategjik të METE. Të gjitha këto do të jenë masa për të cilat është rënë dakort që të jenë në sferën kombëtare të kompetencës.

Mbështetja e Bashkive/Komunave Jo të Favorizuara

107 Mbështetja do të marrë formën e një “fondi shtesë” siguruar nga METE nga buxheti për buxhetin e Programit të Zhvillimit të Zonave Jo të Favorizuara në shkëmbim të një marrëveshjeje nga qarqet për të zbatuar elementet e vendosur të SZHQ të tyre e cila do të favorizojë nxitjen e bashkive/komunave jo të favorizuara të qarkut.

108 Mbështetja do të marri formën e bashkëfinancimit të investimeve të ndërmarra nga qarku ose bashkitë/komunat. Investimet duhet të jetë në një sferë të vendosur të kompetencës të një qarku ose bashkie/komune.

109 Niveli ekzakt i mbështetjes do të negociohet me Qarqet dhe do të konfirmohet në Marrëveshjen e Zhvillimit të Qarkut, por do të jetë më e lartë për:

- Bashkitë/komunat jo të favorizuara të vendosura në një qark jo të favorizuar krahasuar me bashkitë/komunat jo t[favorizuara të lokalizuara në një zone jo të favorizuar NUTS 3.
- Kategoria 1 e bashkive/komunave të pafavorizuara krahasuar me Kategorinë 2 të bashkive/komunave.

Objekti 2: Kapaciteti i Zhvilluar Kombëtar i Qarkut në trajtimin e disavantazheve

110 Objekti i dytë i këtij programi është ndërtimi i kapacitetit në nivel kombëtar, brenda qarqeve dhe zonave të pafavorizuara, për të punuar së bashku me një synim të caktuar për të trajtuar disavantazhet.

111 Kjo kërkon një grup të ri profesionistësh të zhvillimit brenda institucioneve të menaxhimit dhe agjencive të tjera qeveritare – ku nevojiten aftësi dhe kompetenca të reja për menaxhimin e programeve të zhvillimit ndër-sektorial.

112 Pasi të përfundohet përcaktimi i zonave të pafavorizuara, Këshillat e Partneritetit të Qarkut në ato zona do të ftohen të ngrenë një **Grup Pune** i cili do të marri pjesë në përgatitjen dhe menaxhimin e strategjive të zhvillimit për ato zona në qarkun e tyre. Para fillimit të detyrave të tyre, anëtarët e GP duhet të trajnohen për aftësitë që nevojiten për detyrën e tyre, si për shembull metodat e punës në bashkëpunim, hartimin e strategjisë, aftësitë drejtuese dhe menaxhuese. Në një fazë të mëvonshme, do të jetë i nevojshëm dhe ndërtimi i kapacitetit në nivelin e përfitimeve të mundshme locale për të përgatitur dhe zbatuar projektet. Stafit i AZHQ do të ketë gjithashtu nevojë për të marrë trajnime me qëllim që ata të mund të mbështesin zhvillimin e pjesëve më të varfëra të qarqeve përkatëse.

3.3 Kuadri Ligjor për Zhvillimin Rajonal

3.3.1 Ligji për Zhvillimin Rajonal

113 Ka të ngjarë që një Ligj specifik për Zhvillimin Rajonal të jetë esencial për arritjen e kohezionit dhe koherencës në një zone të komplikuar ndër-sektoriale duke kërkuar politika domethënëse dhe koordinim të menaxhimit. Duhet të vlerësohet që formulimi dhe dekretimi i Ligjit mbi Zhvillimin Rajonal duhet të kalojë vetëm nëpërmjet një procesi të gjerë konsultimesh për Strategjinë Gjithpërfshirëse të Zhvillimit Rajonal. Vetëm pasi të jetë arritur konsensusi politik për mënyrën ekzakte të zbatimit të strategjisë, për strukturat institucionale dhe kërkesat për financim, Ligji duhet të hyjë në fuqi.

114 Ligji për Zhvillimin Rajonal pritet të rregullojë qëllimet dhe parimet në lidhje me menaxhimin e zhvillimit rajonal në Republikën e Shqipërisë.

115 Ligji duhet të përcaktojë:

- Konceptin dhe parimet bazë të zhvillimit rajonal: duke u siguruar që terminologjia që do të përdoret të njihet gjerësisht.

- Përkufizimin dhe përdorimin e dokumenteve esenciale të planifikimit strategjik për zhvillimin rajonal
- Kuadrin institucional dhe strukturën e menaxhimit për zhvillimin rajonal
- Marrëveshjet ligjore që janë të nevojshme për zbatimin e instrumenteve të zhvillimit të parashikuara në Ligj
- Metodologjinë për vlerësimin e nivelit të disavantazheve të qarqeve dhe bashkive/komunave
- Burimet financiare për zbatimin e politikës së zhvillimit rajonal, dhe
- Metodologjinë për monitorimin dhe vlerësimin e politikës së Shqipërisë për zhvillimin rajonal.

116 Pas dekretimit të tij, Ligji do të prezantojë bazën ligjore për të gjitha veprimet e zhvillimit rajonal dhe do të pasqyrojë drejtimit dhe objektivat kryesore të politikës rajonale. Për më tepër, Ligji do të sigurojë bazën për prezantimin e parimeve të përgjithshme të politikës rajonale të BE dhe do të sigurojë bazën fillestare për përdorim në të ardhmen të fondeve strukturore të BE.

117 Disa nga karakteristikat dhe objektivat kryesore të Ligjit për Zhvillimin Rajonal janë:

- Promovimi i parimeve Europiane dhe kombëtare të zhvillimit rajonal. Ligji duhet të ndërtohet rreth parimeve kryesore që lidhen me fondet strukturore të BE (partneriteti, programimi, etj.).
- Përcaktimi i dokumenteve të programimit për politikën strukturore dhe zhvillimin rajonal në nivelin kombëtar dhe atë të qarkut dhe hierarkia e tyre dhe ndër-mardhëniet (duke përfshirë dokumentet e nevojshme për programimin e mbështetjes së BE).
- Prezantimi i mekanizmave të rinj për bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të nivelit qendror dhe rajonal si dhe mekanizmat për inkurajimin e një bashkëpunimi më të gjerë. Kjo duhet të bëhet e mundur nëpërmjet instrumenteve si për shembull “marrëveshja e partneritetit të qarkut” ndërmjet shtetit dhe autoriteteve publike në nivelin e qarkut dhe nivelin kombëtar.
- Sigurimi i qartësisë së koncepteve dhe terminologjisë nëpërmjet formulimit të përkufizimeve dhe parimeve bazë.
- Prezantohet modeli për kategorizimin e qarqeve dhe bashkive/komunave sipas nivelit të tyre të disavantazheve.
- Vendoset një grup kriteresh të qëndrueshme për përcaktimin e zonave jo të favorizuara.
- Përcaktimi i një baze ligjore për miratimin e Planit të Qeverisë për Zhvillimin e Zonave Jo të Favorizuara.
- Fleksibiliteti i kuadrit ligjor arritur me anë të vendosjes së themelit për adoptimin e akteve shpeshë ligjore të nivelit më të ulët.
- Sigurimi i bazës për ligjshmërinë, monitorimin dhe vlerësimin. Prezantimi i bazës për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe për vlerësimin *ex-ante*, e përkohshëm, dhe *ex-post* të politikës rajonale është një nga objektivat kryesore të standardizimit ligjor në fushën e zhvillimit rajonal.

118 Nën-ndarja administrative e Republikës së Shqipërisë dhe sistemi i qeverisë locale dhe rajonale, i cili formon një dimension të rëndësishëm të kuadrit të politikës rajonale, do të mbeten të pandryshuara nga Ligji i propozuar për Zhvillimin Rajonal.

3.3.2 *Fleksibiliteti në Ligjin për Zhvillimin Rajonal*

119 Aty ku është e mundur duhet të arrihet fleksibiliteti duke mos e bërë Ligjin shumë të hollësishëm, por duke përdorur legjislacionin dytësor dhe rregulloren e cila mund të ndryshohet më thjesht kur është nevojë. Rregullorja e mëposhtme dytësore mund të jetë e nevojshme:

- Rregullorja e Këshillit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal (shiko seksionin 3.4). Këshilli do të themelohet nga Ligji me qëllimin e koordinimit të zhvillimit rajonal. Çështjet specifike që lidhen me strukturën, juridiksionit dhe metodat e punës së Këshillit, rimbursimin e kostove të konsulentëve teknikë pranë Këshillit si dhe çështje të tjera të rëndësishme duhet të rregullohen me anë të rregullores dytësore.
- Rregullorja për Këshillin e Partneritetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Këshillat e Partneritetit të Qarkut. Çështjet e hollësishme që lidhen me anëtarësinë dhe strukturën e Këshillit të Partneritetit do të rregullohen me rregulloren dytësore.
- Rregullorja për Agjencitë e Zhvillimit të Qarkut. Kushtet që udhëheqin aktivitetet dhe financimin e Agjencisë së Zhvillimit të Qarkut do të përshkruhen nga rregullorja dytësore.
- Rregullorja për Udhëzimet Kombëtare për Strategjitë e Zhvillimit të Qarkut të cilat sigurojnë kuadrin kombëtar të politikës për përgatitjen e Strategjive të Zhvillimit të Qarkut.
- Rregullore për procedurën dhe metodologjinë e vlerësimit të Strategjive të Zhvillimit të Qarkut dhe të gjithë SNZH.

3.3.4 *Marrëveshja e Zhvillimit të Qarkut*

120 Strategjitë e Zhvillimit të Qarkut, përpunuar sipas udhëzimeve kombëtare, do të jenë tema e negociemeve me institucionet e qeverisë qendrore. Këto negocieme do të çojnë në një marrëveshje ndërmjet qeverisë qendrore dhe Qarkut për angazhimet për mbështetje financiare nga qeveria qendrore për realizimin e prioriteteve të vendosura brenda strategjisë. Kjo marrëveshje, Marrëveshja e Zhvillimit të Qarkut, do të mbulojë një periudhë prej 5 vjetësh dhe do të jetë kuadri i referencës për të gjithë financimin zhvillimit në të ardhmen nga qendra në qark. Projekteve të mëpasshme dhe mundësive për mbështetje financiare nga burimet e qeverisë qendrore, qoftë nga partneriteti ose nga operatorë të tjerë socialë-ekonomikë në qark, do t'u kërkohet të demonstrojnë se si oferta lidhet me marrëveshjen e zhvillimit të qarkut.

121 Marrëveshja e Zhvillimit të Qarkut (shiko aneksin 5 për një bazë të mundshme më të hollësishme) do të përmbajë:

- Përcaktimin e palëve kontraktuese në marrëveshjen e zhvillimit të qarkut
- Prioritetet e përbashkëta të zhvillimit të cilat formojnë bazën e marrëveshjes së zhvillimit të qarkut
- Shuma totale e fondeve që janë vendosur për të financuar zbatimin e prioriteteve sipas shpërndarjes së planifikuar vjetore të fondeve dhe burimeve të planifikuara financiare (burime kombëtare, të qarkut, dhe të bashkisë/komunës) ku çdo burim ka pjesën e vet.

- Baza e shpenzimeve të fondeve në vend (shpenzimet direkte nga qeveria qendrore, bashkëfinancimi i shpenzimeve të qarkut/bashkisë/komunës, përdorimi i deleguar i finances së buxhetit kombëtar nga autoritetet e qarkut/bashkisë, etj.).
- Procedurat, data dhe afatet kohore për raportimin e aktiviteteve në lidhje me realizimin e prioriteteve dhe përdorimin e fondeve të shpërndara.
- Procedurat dhe programi për monitorimin dhe vlerësimin e realizimit të prioriteteve të kontraktuara.
- Detyrimet që lidhen me vlerësimin e arritjeve të marrëveshjes së zhvillimit të qarkut të synimeve të para-caktuara
- Periudha e vlefshmërisë së marrëveshjes së zhvillimit të qarkut (pesë vjet).

122 Marrëveshja e zhvillimit të qarkut mund të vendosi gjithashtu dhe çështje të tjera që lidhen me inkurajimin e zhvillimit ekonomik dhe social në territorin e qarkut, veçanërisht ato çështje që kanë të bëjnë me zhvillimin urban dhe zhvillimin e zonave të cilat kanë vështirësi të zhvillohen dhe që janë të lokalizuara në territorin e një qarku në të cilin është konkluduar dhe marrëveshja e zhvillimit të qarkut.

3.4 Kuadri Institucional për Zhvillimin Rajonal


123 Për të hartuar dhe menaxhuar në mënyrë sa më efektive politikën rajonale është i nevojshëm një kuadër domethënës institucional. Për këtë arsye duhet të kihet mirë parasysh që strukturat e propozuara do të jenë gjithashtu të nevojshme për menaxhimin e ardhshëm të fondeve të para-pranimit në BE (veçanërisht ato fonde që synojnë kohezionin ekonomik dhe social) dhe të pas-pranimit, Fondet Strukturore të BE.

124 Strukturat Institucionale mund të ndahen në struktura kombëtare dhe nën-kombëtare dhe ndërmjet strukturave konsultative dhe të zbatimit.

Strukturat Kombëtare

Konsultimi

3.4.1 Këshilli i Partneritetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal (KPKZHR)



125 KPKZHR është një organ konsultativ i nivelit kombëtar i përbërë nga përfaqësues të sectorëve publikë (administrata shtetërore qendrore, këshillat e qarqeve, bashkitë dhe komunat), private dhe civile dhe do të themelohet në përputhje me Ligjin për Zhvillimin Rajonal.

126 Brenda jurisdiksionit të vet KPKZHR pritet që:

- Të këshillojë Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë për efektivitetin dhe cilësinë e SNZH, Planin për Zhvillimin e Zonave Jo të Favorizuara dhe dokumente të tjerë kryesorë të politikës dhe planifikimit për zhvillimin rajonal (duke përfshirë dhe ato që i janë dorëzuar Komisionit Europian në kuadrin e marrjes dhe përdorimit të fondeve të BE) dhe, aty ku është e nevojshme, bën propozime që lidhen me përmirësimin e dokumenteve të tilla;
- Të këshillojë Ministrin për efektivitetin dhe cilësinë e a) Udhëzimeve Kombëtare për Përgatitjen e Strategjive të Zhvillimit të Qarkut; (b) kriteret për akreditimin e Agjencive për Zhvillimin e Qarkut dhe (c) modelin e zhvillimit social-ekonomik, dhe (d) propozimet për kategorizimin e zonave jo të favorizuara në përputhje me Ligjin për Zhvillimin Rajonal dhe, aty ku është e nevojshme bën propozime që lidhen me përmirësimin e dokumenteve të tilla;
- Të këshillojë Ministrin për efektivitetin dhe cilësinë e Strategjive të Zhvillimit të Qarkut (dhe për dokumente të tjera rajonale të cilat mund të përgatiten për të programuar përdorimin e fondeve të BE) dhe, aty ku është e nevojshme, bën propozime për përmirësimin e dokumenteve të tilla;
- Të monitorojë efektivitetin dhe cilësinë e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, programet e saj përbërëse dhe plane dhe politika të tjera kryesore të zhvillimit rajonal (duke përfshirë ato që financohen pjesërisht ose plotësisht nga fondet e BE) në këtë aspekt ai do të:

- i. Rishikojë periodikisht progresin e bërë drejt arritjes së synimeve specifike të Planit të Veprimit të SNZHR dhe planet dhe politikat e tjera kryesore të zhvillimit rajonal mbi bazën e dokumenteve që dorëzohen nga sekretariati. Rishikime të tilla duhet të zhvillohen duke iu referuar treguesve financiarë dhe treguesve të zbatimit, rezultateve dhe ndikimit i cili mund të specifikohet në planet kombëtare dhe dokumentet e politikës.
 - ii. Konsiderojë dhe aprovojë raportet vjetore dhe finale për zbatimin e Planit të Veprimit të SNZHR dhe plane e politika të tjera kryesore të zhvillimit rajonal;
 - iii. Propozojë Ministrin ndonjë rregullim ose shqyrtim të SGJZHR ose plane e politika të tjera të zhvillimit rajonal për të mundësuar arritjen e objektivave të planit ose politikës ose për të përmirësuar menaxhimin e tij, duke përfshirë menaxhimin e tij financiar;
- T'i dorëzojë një Raport Vjetor Ministrin për operimin e KKPZHR dhe zbatimin e SNZHR, duke përfshirë: (i) progresin e bërë në zbatimin e Planit të Veprimit për SNZHR në mardhënie me synimet e tij specifike dhe të verifikueshme, me matjen e sasisë, kudo dhe kurdo që ofrohen për t'u matur, të treguesve fizikë dhe treguesve të zbatimit, rezultateve dhe impaktit; dhe (b) një raport për zbatimin financiar të planit dhe politikave të zhvillimit kombëtar.

127 Funkzioni i sekretariatit për KKPZHR sigurohet nga METE.

Këshilli Kombëtar i Partneritetit për Zhvillimin Rajonal duhet të themelohet me anë të Ligjit për Zhvillimin Rajonal. Në periudhën afat-mesme sugjerohet me force themelimi i një këshilli të partneritetit afat-mesëm (ad hoc) për të monitoruar zbatimin e Planit të Veprimit për SNZHR dhe për të këshilluar formulimin e versionit final të SNZHR dhe formulimin e Ligjit për Zhvillimin Rajonal. Antaret aktuale të Keshillit të Partneritetit Kombëtar të perkohshëm paraqiten në Aneks 2.

Zbatimi

3.4.2 Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë (Departamenti i Programimit Strategjik)

128 METE projekton Strategjinë Ndersektorale të Zhvillimit Rajonal dhe ato dokumente të nevojshme për programimin e përdorimit që Shqipëria i bën programeve të mbështetjes së BE për zhvillimin rajonal për t'u marrë në considerate nga KKPZHR dhe këshillon po këtë organ për dokumentet e zhvillimit rajonal në nivelin e qarkut (Strategjitë e Zhvillimit të Qarkut dhe Projekte të Përbashkëta të Zhvillimit dhe dokumentet e qarkut të përgatitura për programimin që Shqipëria i bën programeve mbështetëse të BE për zhvillimin rajonal).

129 METE është përgjegjëse për:

- programimin e PZHQB, duke përfshirë: (a) përgatitjen e Udhëzimeve Kombëtare për PZHQB në konsultim me të gjitha organet përkatëse; (b) negociimin e Marrëveshjes së Zhvillimit të Qarkut për çdo qark me Qarkun dhe Ministrinë e Linjës; (c) negociimin me këshillat e qarkut e bazës financiare për Agjencitë e Zhvillimit të Qarkut dhe marrja e angazhimeve nëpërmjet Marrëveshjes së Zhvillimit të Qarkut për çdo qark.
- programimin e PZHQB, duke përfshirë: (a) përgatitjen e Planit të Qeverisë për Zhvillimin e Zonave Jo të Favorizuara; (b) përgatitjen e udhëzimeve për operimin e elementeve mbështetëse të

PZHJF të Qarqeve Jo të Favorizuara dhe Bashkitë/Komunat Jo të Favorizuara; (c) negocimin me Ministrinë e Linjës në lidhje me angazhimet e tyre nën elementin e mbështetjes të PZHJF të Qarqeve Jo të Favorizuara; dhe (d) negocimin me qarqet përsa i përket përgjegjësive dhe angazhimeve të METE nën elementin e mbështetjes së PZHJF të Bashkive/Komunave Jo të Favorizuara.

130 METE mban dhe përditëson rregullisht kategorizimin e disavantazheve në përputhje Ligjin për Zhvillimin Rajonal.

131 METE akrediton të gjitha Agjencitë e Zhvillimit të Qarkut në përputhje me Ligjin për Zhvillimin Rajonal.

132 METE është përgjegjëse për:

- Zbatimin e të gjitha Marrëveshjeve për Zhvillimin e Qarkut për të siguruar që janë përmbushur plotësisht të gjitha angazhimet që janë marrë në këshillat kombëtarë dhe këshillat e qarqeve;
- Përmbushjen e të gjitha angazhimeve të marra nga Ministrinë e Linjës në lidhje me zbatimin e elementit mbështetës të PZHJF të Qarqeve Jo të Favorizuara;
- Përmbushjen e angazhimeve të marra nga qarqet në lidhje me zbatimin e elementit mbështetës të PZHJF të Bashkive/Komunave Jo të Favorizuara;
- Zbatimin e Strategjive të Zhvillimit të Qarkut përkundrejt treguesve të përcaktuar të monitorimit;
- Zbatimin e Planit të Qeverisë për Zhvillimin e Zonave Jo të Favorizuara përkundrejt treguesve të përcaktuar të monitorimit.

133 METE përgjigjet vetëm për kryerjen e pagesave dhe sigurimin e kontrollit financiar të:

- Financimit të dhënë nën PZHQ lidhur me financimin e Agjencive të Zhvillimit të Qarkut.
- Financimit të dhënë sipas elementit mbështetës të PZHJF të Bashkive/Komunave Jo të Favorizuara.

134 Sektori i Prognozës dhe Zhvillimit Rajonal I METE, brenda Departamentit të Programimit Strategjik, aktualisht përbëhet nga një staf prej tre vetash; kjo do të kërkojë zgjerim të madh dhe ndërtim kapaciteti me qëllim që të merret përsipër ky rol i ri.

3.4.3 Ministrinë e Linjës

135 Ministrinë e Linjës angazhohen nëpërmjet Marrëveshjes së Zhvillimit të Qarkut (në përputhje me PKZHQ) për të shpenzuar shumën specifike të buxhetit të tyre për financimet e investimeve në qarqe specifike në përputhje me prioritetet e përcaktuara në Strategjitë e Zhvillimit të Qarkut të atyre qarqeve.

136 Ministrinë e Linjës gjithashtu angazhohen, nën PZHJF, për të vendosur shumën specifike nga skemat e tyre të ndihmës për shpenzime në qarqet e kategorizuara si "jo të favorizuara". Ata gjithashtu angazhohen të vendosin terma dhe kushte për këto skema ndihme duke trajtuar në mënyrë të favorshme përfituesit e mundshëm të lokalizuar brenda qarqeve të kategorizuara si "jo të favorizuara". Përkundrejt këtij angazhimi METE "shton" buxhetin për skemën e ndihmës së emërtuar me një shumë të negociuar.

137 Ministria e Linjës përgjigjet për kryerjen e pagesave, zbatimin e monitorimit dhe sigurimin e kontrollit financiar për financimet e bëra nën PZHQ dhe PZHJZF (duke përfshirë “shtesën” siguruar nga METE).

Niveli nën-kombëtar

Konsultativ

3.4.4 Këshilli i Partneritetit të Qarkut

138 Këshilli i Partneritetit të Qarkut (KPQ) është një organ këshillues i nivelit të qarkut i përbërë nga përfaqësues të sektorit publik (këshillat e qarqeve, bashkive dhe komunave nga territori i qarkut, dhe organet e administratës qendrore shtetërore që merren me çështjet e lidhura me zhvillimin në territorin e qarkut), sektorit privat dhe civil dhe është krijuar me qëllimin e sigurimit të këshillave në lidhje me përgatitjen dhe zbatimin e politikës së zhvillimit rajonal në nivelin e qarkut (duke përfshirë dokumentet e përgatitura në nivelin e qarkut për programimin e përdorimit që Shqipëria i bën programeve mbështetëse të BE për zhvillimin rajonal), duke arritur konsensusin ndërmjet palëve të ndryshme të interesuara dhe duke marrë pjesë në planifikimin e zhvillimit të qarkut.

3.4.5 Këshilli i Qarkut

139 Këshilli i Qarkut krijon Këshillin e Partneritetit të Qarkut dhe Agjencinë e Zhvillimit të Qarkut në përputhje me kriteret e vendosura në Ligjin për Zhvillimin Rajonal.

140 Ai gjithashtu miraton Strategjinë e Zhvillimit të Qarkut dhe konkludon Marrëveshjen e Zhvillimit të Qarkut për qarkun e tij.

3.4.6 Agjencia e Zhvillimit të Qarkut

141 Agjencia e Zhvillimit të Qarkut krijohet nga këshilli i qarkut (në lidhje me bashkitë dhe komunat nga i njëjti qark).

142 Agjencia e Zhvillimit të Qarkut përgatit strategjinë e zhvillimit të qarkut, dokumentet e përgatitura në nivelin e qarkut për programimin e përdorimit që Shqipëria i bën programeve mbështetëse të BE për zhvillimin rajonal dhe dokumentet e përbashkëta të programimit (kjo e fundit në lidhje të ngushtë me një ose më shumë AZHQ që mbulojnë qarqet e përfshira në Përkjetin e Përbashkët të Zhvillimit), koordinon zbatimin e tyre dhe monitoron impaktin e tyre.

143 Agjencia e Zhvillimit të Qarkut – inë bashkëpunim me Partneritetin e Qarkut – identifikon nevojat e zhvillimit dhe kërkesat e investimit të zonave jo të favorizuara Brenda qarkut të tyre. Këto do të jepen në Kapitullin mbi Zonat Jo të Favorizuara brenda Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut. Agjencia e Zhvillimit të Qarkut përgjigjet për zbatimin e elementit Mbështetës të Bashkive/Komunave Jo të Favorizuara të PZHJZF brenda qarkut të tyre.

144 Detyra e tyre do të përfshijnë lehtësimin e përgatitjes së projektit nga grupet locale dhe zhvillimin e një zinxhiri të projekteve të mundshme për financim nga donatorë të huaj ose vendas. Zhvillimi i një sere projektesh do të jetë thelbësor për përdorimin e efektshëm të burimeve të para-pranimit dhe pas-pranimit në BE; AZHQ do të luajnë një rol vendimtar në këtë proces.

145 Agjencia e Zhvillimit të Qarkut siguron dhe funksionin e sekretariatit për KPQ. Agjencia e Zhvillimit të Qarkut përgjigjet për monitorimin:

- E zbatimit të Marrëveshjes për Zhvillimin e Qarkut për qarkun e tyre;
- E zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut për qarkun e tyre përkundrejt treguesve të përcaktuar të monitorimit;

4. Implikimet e burimeve

146 Pjesa më e madhe e financimeve për SNZHR do të përfshihet brenda strategjive sektoriale. Kështu, sipas Programit të Zhvillimit të Qarkut elementi kryesor i financimit është mbështetja financiare nga Qeveria Qendrore për të zbatuar elementet e prioriteteve dhe projekteve të investimit të përshkruara brenda Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut dhe vendosur nëpërmjet Marrëveshjes së Zhvillimit të Qarkut. Mbështetja financiare nga Qeveria Qendrore për të zbatuar elementet e prioriteteve dhe projektet e investimit të përshkruara brenda Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut, në përgjithësi do të jetë neutrale nga ana e buxhetit; kjo nuk kërkon fonde shtesë, por më tepër një marrëveshje që ministritë e linjës të përdorin një element të buxhetit ekzistues të investimit kombëtar për të ndihmuar mbështetjen e investimeve të parashikuara në Strategjinë e Zhvillimit të Qarkut dhe të cilat janë në përputhje me prioritetet kombëtare të investimeve.

147 Natyra e investimit të ministrisë së linjës (investim i drejtpërdrejtë, investim i bashkë-financuar me një qark ose bashki/komunë, ose kontroll i deleguar i fondeve në një qark ose bashki/komunë për zbatimin e tyre) do të ndryshojë dhe do të jetë temë e negociimit dhe marrëveshjes ndërmjet ministriesë së linjës, METE dhe Qarkut. Niveli i mbështetjes do të variojë në varësi të klasifikimit të “Shkallës së zhvillimit social-ekonomik” të çdo qarku. Marrëveshja finale do të ratifikohet në një Marrëveshje të Zhvillimit të Qarkut firmosur nga Qeveria dhe Qarku. Këto shuma do të përfshihen brenda buxheteve të strategjive të ndryshme sektoriale.

148 Në mënyrë të ngjashme, pjesa më e madhe e financimeve për veprimet në zonat jo të favorizuara duhet të vijë nga strategjitë sektoriale (duke përfshirë grantin konkurses të komunës/bashkisë).

149 Kërkesat specifike të financimit të SNZHR (që nuk përfshihen në strategjitë sektoriale) lidhen me:

- Mbështetjen financiare nga Qeveria Qendrore për të mbuluar një pjesë të krijimit dhe kostove operative në çdo qark të Partneritetit të Qarkut dhe një Agjenci e Zhvillimit të Qarkut do të kërkojë financime shtesë Brenda buxhetit kombëtar. Mbështetja do të mbulojë një përqindje të krijimit të vendosur dhe kostot operative të Partneritetit të Qarkut dhe Agjencisë së Zhvillimit të Qarkut deri në një maksimum të mundshëm. Përqindja e mbështetjes që do të sigurohet do të bazohet në klasifikimin e “Shkallës së zhvillimit social-ekonomik” të çdo qarku. Mbështetja do të sigurohet sipas një shaklle zvogëluese përgjatë ciklit të jetës së SNZHR. Është planifikuar që qarqet do të mbështen për të krijuar dhe vënë në veprim Agjencitë e Zhvillimit të Qarkut ku niveli i mbështetjes varion në varësi të kësaj shaklle të zhvillimit social-ekonomik. Gjithashtu është planifikuar që mbështetja e qeverisë qendrore duhet të jetë sipas një shaklle zvogëluese me qarqet të cilat marrin koston e plotë të funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Qarkut. Për këtë mund të përdoret shaklla e mbështetjes e dhënë në tabelën e mëposhtme. Përqindja e financimit përfaqëson përqindjen e koston që do të mbulohet nga METE nga buxheti i tij i PZHQ; bilanci duhet të financohet nga themeluesit e Agjencisë së Zhvillimit të Qarkut. Shifrat e sakta mund të vendosen vetëm duke ndjekur vendosjen e nivelit të disavantazhit. Asistenca teknike dhe trajnimi duhet të sigurohen për të gjitha AZHQ/KPQ (veçanërisht në lidhje me përgatitjen e SZHQ dhe negociimin e saj për të arritur në një Marrëveshje të Zhvillimit të Qarkut) – shpresojmë nëpërmjet programeve mbështetëse të para-pranimit të BE dhe mbështetje të tjera nga donatorët.

STRATEGJIA NDERSEKTORIALE PER ZHVILLIMIN RAJONAL

Grupi i Indeksit të Disavantazhit	Kostot e Themelimit	Viti 1 Kostot Operative	Viti 2 Kostot Operative	Viti 3 Kostot Operative	Viti 4 Kostot Operative	Viti 5 Kostot Operative
I	75%	75%	50%	25%	10%	0%
II	50%	50%	25%	10%	0%	0%
III	25%	25%	10%	0%	0%	0%
IV	10%	10%	0%	0%	0%	0%
V	0%	0%	0%	0%	0%	0%

- Financimi për elementet e “Mbështetjes së Qarqeve Jo të Favorizuara” dhe “Mbështetjes së Bashkive/Komunave Jo të Favorizuara” të Programit të Zhvillimit të Zonave Jo të Favorizuara. Buxheti sërish nuk mund të vlerësohet sa kohë që nuk është vendosur niveli i disavantazhit.

5. Kontabilizimi, monitorimi dhe vlerësimi

150 Treguesi kryesor i suksesit në lidhje me SNZHR do të jetë arritja e Planit të Veprimit për zbatimin e SNZHR.

151 Progresi do të monitorohet dhe vlerësohet nga Keshilli Kombëtar I perkohshem I

Aneksi 1: Proçesi I konsultimeve per finalizmin e Strategjise Ndersektorale per Zhvillimin Rajonal

Raundi i pare i konsultimeve te draftit te SNZHR

LISTA E INSTITUCIONEVE QE KANE NDJEKUR WORKSHOPIN PER SNZHR ORGANIZUAR NE TIRANE ME 27 NENTOR 2006 ME PJESMARRJEN E RAJONEVE TIRANE, DURRES E FIER

NR.	INSTITUCIONI / ORGANIZATA
1	MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
2	MINISTRIA E BRENDESHME
3	MINISTRIA E SHENDETSISE
4	DREJTORIA E KUJDESIT SHENDETSOR PARESOR (FIER)
5	DREJTORIA RAJONALE E SH.S.SH. LEZHE
6	DREJTORIA E SHENDETIT PUBLIK VLORE
7	MINISTRIA E MJEDISIT, UJRAVE DHE ADMINISTRIMIT TE PYJEVE
8	MINISTRIA E BUJQESISE, USHQIMIT DHE MBROJTJES SE KONSUMATORIT
9	DREJTORIA SHERBIMIT PYJOR DURRES
10	D.R.B.U.M.K. Durres
11	MINISTRIA E E PUNES, ÇESHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TE BARABARTA
12	ZYRA RAJONALE E PUNESIMIT TIRANE
13	DREJTORIA RAJONALE E PUNESIMIT (FIER)
14	MINISTRIA E INTEGRIMIT EUROPIAN
15	DBSKSNH
16	PREFEKTI I QARKUT DURRES
17	PREFEKTI I QARKUT FIER
18	KESHILLI I QARKUT TIRANE
19	KESHILLI I QARKUT DURRES
20	KESHILLI I QARKUT FIER
21	BASHKIA VORE
22	BASHKIA FIER
23	BASHKIA PATOS
24	SHOQATA QARQEVE
25	Komuna GJEPAL (DURRES)
26	AGJENCIA RAJONALE E ZHVILLIMIT TIRANE
27	AGJENCIA RAJONALE E ZHVILLIMIT DURRES
28	INSTAT
29	UNDP
30	USAID
31	REC
32	SIPU
33	SIDA
34	SNV
35	Istituti i Kerkimeve Urbanistike (URI)
36	NGO Durres (Terre Des Hommes)
37	NGO Durres (Emancipimi Gruas, progres per shoqerine)
38	KONSULENTE LOKALE

LISTA E INSTITUCIONEVE / ORGANIZATAVE PJESMARRESE QE KANE NDJEKUR WORKSHOPIN E ORGANIZUAR NE KORÇE ME 1 DHJETOR 2006 ME PJESMARRJEN E QARQEVE KORÇE E ELBASAN

NR.	INSTITUCIONI / ORGANIZATA
1	MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
2	MINISTRIA E BRENDESHME
3	MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES
4	MINISTRIA E SHENDETESISE
5	DREJTORIA SHENDETIT PUBLIK ELBASAN
6	MINISTRIA E MJEDISIT, UJRAVE DHE ADMINISTRIMIT TE PYJEVE
7	AGJENCIA RAJONALE E MJEDISIT KORÇE
8	MINISTRIA E BUJQESISE, USHQIMIT DHE MBROJTJES SE KONSUMATORIT
9	DREJTORIA RAJONALE E BUJQESISE ELBASAN
10	MINISTRIA E PUNES, ÇESHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TE BARABARTA
11	PREFEKTI I QARKUT KORÇE
12	PREFEKTIT I QARKUT ELBASAN
13	KRYETARI I KESHILLIT QARKUT KORÇE
14	KESHILLI I QARKUT ELBASAN
15	BASHKISE KORÇE
16	BASHKISE LESKOVIK
17	BASHKISE POGRADEC
18	KRYETARI I BASHKISE ELBASAN
19	SHOQATA E QARQEVE (Drejtor Ekzekutiv)
20	SHOQATA E KOMUNAVE
21	UNIONI DHOMAVE TREG. E IND.
22	DEGES SE DHOMES TREG. E IND. KORÇE
23	AGJENCIA RAJ. E ZHVILL. KORÇE
24	QENDRA E ZHVILLIMIT TE SHOQERISE CIVILE
25	SNV
26	Kryetari Komunes Pojan
27	Kryetari Komunes Qender Bilisht
28	Kryetari Komunes Gjinar Elbasan
29	Kryetari Komunes Hotolisht Librazhd
30	Kryetari Komunes Qukes
31	Kryetari Komunes Lenie Gramsh
32	Kryetari Komunes Kushove Gramsh
33	Kryetari Komunes Kodovjat Gramsh
34	Kryetari Komunes Mollaj Korçe
35	Kryetari Komunes Rrajçe Librazhd
36	Kryetari Komunes Orenje Librazhd
37	Kryetari Komunes Polis

LISTA E INSTITUCIONEVE / ORGANIZATAVE PJESMARRESE QE KANE NDJEKUR WORKSHOPIN E ORGANIZUAR NE VLORE ME 5 DHJETOR 2006 ME PJESMARRJEN E QARQEVE VLORE, GJIROKASTER DHE BERAT

NR.	INSTITUCIONI /ORGANIZATA
1.	MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
2	MINISTRIA E BRENDESHME
3	MINISTRIA E BUJQESISE, USHQIMIT DHE MBROJTJES SE KONSUMATORIT
4	DREJTORIA RAJONALE E BUJQESISE BERAT
5	PREFEKTI I QARKUT VLORE
6	KESHILLI I QARKUT VLORE
7	KESHILLI I QARKUT GJIROKASTER
8	BASHKIA VLORE
9	BASHKIA URA VAJGURORE
10	DEGA E DHOMES TREG. E IND. VLORE
11	AGJENCIA RAJ. E ZHVILL. VLORE
12	INSTAT
13	KRYETARI I KOMUNES POSHNJE -BERAT

LISTA E INSTITUCIONEVE/ORGANIZATAVE PJESMARRESE QE KANE NDJEKUR WORKSHOPIN E ORGANIZUAR NE LEZHE ME 8 DHJETOR 2006 ME PJESMARRJEN E QARQEVE LEZHE, SHKODER,KUKES DHE DIBER

N/R	INSTITUCIONI / ORGANIZATA
1	MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
2	MINISTRIA E BRENDESHME
3	MINISTRIA E ARSIMIT, DHE SHKENCES
4	MINISTRIA E SHENDETESISE
5	MINISTRIA E MJEDISIT, UJRAVE DHE ADMINISTRIMIT TE PYJEVE
6	MINISTRIA E BUJQESISE, USHQIMIT DHE MBROJTJES SE KONSUMATORIT
7	MINISTRIA E PUNES, ÇESHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TE BARABARTA
8	DBSKSNH
9	PREFEKTI I QARKUT LEZHE
10	PREFEKTI I QARKUT SHKODER
11	PREFEKTI I QARKUT KUKES
12	PREFEKTI I QARKUT DIBER
13	KESHILLI I QARKUT LEZHE
14	KESHILLI I QARKUT KUKES
15	KESHILLI I QARKUT SHKODER
16	KESHILLI I QARKUT DIBER
17	BASHKIA LEZHE
18	BASHKIA MAMURRAS
19	BASHKIA LAÇ
20	BASHKIA RRESHEN
21	SHOQATA E QARQEVE
22	SHOQATA E KOMUNAVE
23	DEGA E DHOMES TREGTISE DHE INDUSTRISE LEZHE
24	DEGA E DHOMES TREGTISE DHE INDUSTRISE SHKODER
25	AGJENCIA RAJONALE E ZHVILLIMIT LEZHE
26	AGJENCIA RAJONALE E ZHVILLIMIT SHKODER
27	INSTAT
28	REC
29	SNV
30	Kryetari Komunes BARBULLUSH, Shkoder
31	Kryetari Komunes BUSHAT, Shkoder
32	Kryetari Komunes DAJC, Shkoder
33	Kryetari Komunes HAJMEL, Shkoder
34	Kryetari Komunes SHLLAK, Shkoder
35	Kryetari Komunes VELIPOJE, Shkoder
36	Kryetari Komunes KASTRAT, Koplik
37	Kryetari Komunes SHKREL, Koplik
38	Kryetari Komunes BALLDREN I RI, Lezhe
39	Kryetari Komunes DAJC, Lezhe
40	Kryetari Komunes KALLMET, Lezhe
41	Kryetari Komunes SHENGJIN, Lezhe
42	Kryetari Komunes MILOT, Laç

LISTAE INSTITUCIONEVE/ORGANIZATAVE PJESMARRESE QE KANE NDJEKUR WORKSHOPIN E ORGANIZUAR NE TIRANE 14 DHJETOR 2006

NR.	INSTITUCIONI / ORGANIZATA
1	MINISTRIA EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
2	MINISTRIA E BRENDESHME
3	MINISTRIA FINANCAVE
4	MINISTRIA E PUNES, ÇESHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TE BARABARTA
5	MINISTRIA E SHENDETSISE
6	MINISTRIA E MJEDISIT, UJRAVE DHE ADMINISTRIMIT TE PYJEVE
7	MINISTRIA E BUJQESISE, USHQIMIT DHE MBROJTJES SE KONSUMATORIT
8	MINISTRIA TURIZMIT, KULTURES RINISE DHE SPORTEVE
9	DBSKSNH
10	SHOQATA QARQEVE
11	SHOQATA KOMUNAVE
12	SHOQATA BASHKIVE
13	INSTAT
14	UNDP
15	USAID
16	REC
17	SIPU
18	SIDA
19	GTZ
20	DfID
21	ZYRA E BASHKEPUNIMIT ZVICERAN
22	AGJENSIA E ZHVILLIMIT AUSTRIAK
23	SNV
24	INSITUTI I KERKIMEVE URBANISTIKE (URI)
25	KONSULENTE LOKALE
26	MADA
27	FSHZH
28	UNIVERSTITETI I TIRANES , FAKULTETI EKONOMIK
29	UNIVERSITETI POLITEKNIK (FAKULTETI I INXHINJERISE MEKANIKE)
30	ALBINVEST

RAUNDI I DYTE I KONSULTIMEVE TE DRAFTIT TE SNZHR

**LISTA E INSTITUCIONEVE PJESMARRESE Ne TAKIMIN
DT 27 Qershor 2007 per SNZHR Tirane**

NR.	INSTITUCIONI/ORGANIZATA
1.	PREFEKTI I QARKUT KORCE
2.	PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
3.	PREFEKTI I QARKUT VLORE
4.	PREFEKTI I QARKUT LEZHE
5.	PREFEKTI I QARKUT DIBER
6.	KESHILLI I QARKUT TIRANE
7.	KESHILLI I QARKUT DURRES
8.	KESHILLI I QARKUT FIER
9.	KESHILLI I QARKUT KORÇE
10.	KESHILLI I QARKUT ELBASAN
11.	KESHILLI QARKUT VLORE
12.	KESHILLI QARKUT GJIROKASTER
13.	KESHILLI I QARKUT BERAT
14.	KESHILLI QARKUT LEZHE
15.	KESHILLI I QARKUT SHKODER
16.	KESHILLI QARKUT KUKES
17.	KESHILLI QARKUT DIBER
18.	UNDP
19.	MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
20.	Ministria e Brendeshme

LISTA E PJESMARRESVE NE TAKIMIN per SNZHR dt. 28 Qershor 2007 ne Shkoder me qarqet Lezhe, Shkoder, Kukes.

NR.	INSTITUCIONI
1	Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes
2	Ministria e Brendshme
3	Keshilli i Qarkut Shkoder
4	Keshilli i Qarkut Lezhe
5	Keshilli i Qarku Kukes
6	Prefektura Qarkut Lezhe
7	Prefektura Qarkut Shkoder
8	Bashkia Lezhe
9	Bashkia Kukes
10	Bashkia Shkoder
11	Bashkia Vau i Dejes
12	Bashkia Puke
13	Bashkia Rreshen
14	Bashkia Mamurras
15	Komuna Qender Malesi e Madhe
16	Komuna Tropoje Bajram Curri
17	Komuna Ana Malit
18	Komuna Rrethinat
19	Komuna Gjegjan Puke
20	Komuna Shtigen
21	Komuna Berdice
22	Komuna Shkrel Malesi e Madhe
23	Komuna Dajç B/B Shkoder
24	Komuna Zejmen
25	Komuna Fush Kuge
26	Dhoma e Tregtise Shkoder
27	Dhoma e Tregtise Lezhe
28	TEULEDA (ARZH)
29	CSDC(Qendra e Zhvillimit te Shoqerise Civile)
30	UNDP

**LISTA E PJESMARRESVE NE TAKIMIN per SNZHR dt. 29 Qershor 2007 ne Tirane
me qarqet Tirane, Durres, Diber.**

NR.	INSTITUCIONI
1	METE
2	Ministria Brendeshme
3	Keshilli I Qarkut Diber
4	Keshilli I Qarkut Durres
5	Keshilli I Qarkut Tirane
6	Prefektura Qarkut Diber
7	Prefektura Qarkut Durres
8	Prefektura Qarkut Tirane
9	Bashkia Klos
10	Bashkia Kavaje
11	Bashkia Durres
12	Bashkia Bulqize
13	Komuna Martanesh Diber
14	Komuna Baz
15	Komuna Buba
16	Komuna Farke Tirane
17	Komuna Kala e Dodes
18	Komuna Komsj
19	Komuna Lis Mat
20	Komuna Macukull
21	Komuna Reç
22	Komuna Selishte Diber
23	Komuna Tomin Diber
24	Komuna Zall Dardhe
25	Shoqata e Komunave te Shqiperise
26	Dhoma e Tregtise dhe Industrise Tirane
27	Dhoma e Tregtise dhe Industrise Durres
28	Dhoma Tregtise dhe Industise Diber
29	Agjensia Rajonale Zhvillimit Tirane
30	Qendra Koordinimit ARZH-ve
31	SNV/Diber
32	UNDP

**LISTA E PJESMARRESVE NE TAKIMIN per SNZHR dt. dt. 2 Korrik 2007 ne Elbasan,
me Qarqet Elbasan e Korçe**

NR.	INSTITUCIONI
1	METE
2	Ministria Brendeshme
3	Keshilli Qarkut Elbasan
4	Keshilli Qarkut Korçe
5	Prefektura Qarkut Elbasan
6	Prefektura Qarkut Korçe
7	Bashkia Elbasan
8	Bashkia Gramsh
9	Komuna Bradashesh
10	Komuna Dardha Pogradec
11	Komuna Gjinav
12	Komuna Gjocas
13	Komuna Gostime Elbasan
14	Komuna Gracen
15	Komuna Hotolisht
16	Komuna Labinot-Mal
17	Komuna Lasuot Fushe ****
18	Komuna Lunik
19	Komuna Mollas Erseke
20	Komuna Novosele Erseke
21	Komuna Perparim
22	Komuna Pojan
23	Komuna Polis
24	Komuna Qender Erseke
25	Komuna Rajce
26	Komuna Shushice
27	Komuna Stebleve
28	Komuna Voskopoje
29	Komuna Vresutas
30	ARZH Korçe
31	INSTAT
32	UNDP

**LISTA E PJESMARRESVE NE TAKIMIN per SNZHR dt. 4 Korrik 2007 ne FIER
me qarqet Fier , Berat**

NR.	INSTITUCIONI/ORGANIZATA
1.	METE
2.	Ministria e Brendeshme
3.	Keshilli Qarkut Berat
4.	Keshilli Qarkut Fier
5.	Prefektura Berat
6.	Prefektura Fier
7.	Bashkia Roskovec
8.	Bashkia Kuçove
9.	Bashkia Berat
10.	Bashkia Lushnje
11.	Komuna Kozane
12.	Komuna Ruzhdie Fier
13.	Komuna Sinje Berat
14.	Komuna Vertop Berat
15.	Komuna Kutalli
16.	Komuna Kuman
17.	Komuna Zharre
18.	Komuna Kolonje
19.	Komuna Prrenjas
20.	Komuna Krutje
21.	Komuna Gjerbes
22.	Komuna Fratar
23.	Komuna Hekal
24.	Komuna Ngraçom
25.	Komuna Kurtaj
26.	Komuna Qender Mallakaster
27.	Agjensia Rajonale e Zhvillimit Fier
28.	UNDP

**LISTA E PJESMARRESVE NE TAKIMIN per SNZHR dt. 6 Korrik 2007 ne VLORE
me qarget Vlore, Gjirokaster**

NR.	INSTITUCIONI/ORGANIZATA
1.	METE
2.	Ministria Brendeshme
3.	Keshilli Qarkut Vlore
5.	Keshilli Qarkut Gjirokaster
6.	Prefektura Gjirokaster
7.	Prefektura Vlore
8.	Bashkia Vlore
9.	Bashkia Sarande
10.	Komuna Qender
11.	Komuna Piskove
12.	Komuna Lunxheria
13.	Komuna Antigone
15.	Komuna Lazarat
16.	Komuna Novosele
17.	Komuna Lukov
18.	Komuna Hore-Vranisht
19.	Komuna Dhiver
20.	Komuna Aliko
21.	Drejtoria Rajonale Arsimore Vlore
22.	Drejtoria Rajonale Bujqesise Vlore
23.	Agjensia Rajonale e Mjedisit
24.	Sigurimet Shoqerore Vlore
25.	INSTAT Vlore
26.	Porti Detar Vlore
27.	Agjensia Auleda
28.	ARZH Vlore
29.	ARZH Gjirokaster
30.	CSCD Program
31.	D.K.S.P.U Vlore
32.	UNDP

**LISTA E ORGANIZATAVE DHE DONATOREVE PJESMARRESE QE KANE MARRE
PJESE NE TAKIMIN E DYTE ME 12 PRILL 2007 E ORGANIZUAR NE TIRANE NGA
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGETIKES**

NR.	INSTITUCIONI/ORGANIZATA
1	METE
2	Bashkepunimi Teknik Austriak
3	Delegacioni I Komisionit European
4	UNDP
5	DFID
6	GTZ
7	Kooperacioni Italian
8	USAID
9	Ambasada Hollandeze
10	SNV
11	SIDA
12	SIPU
13	Zyra e Bashkepunimit Zviceran
14	OSCE
15	Banka Boterore
16	REC
17	MADA
18	Fondi I Zhvillimit Shqiptar

Aneks 2: Keshilli i Partneritetit Kombetar i perkohshem**Perfaqesues te institucioneve te Qeverisjes Qendrore**

N/R	INSTITUCIONI / ORGANIZATA	PERFAQESUESI	FUNKSIONI / POZICIONI
1	MIN.E ARSIMIT DHE SHKENCES	Adriana GJONAJ	ZV / Minister
2	MIN.E SHENDETSISE	Arben IVANAJ	ZV / Minister
3	MIN.E TURIZMIT, KULTURES, RINISE & SPORTEVE	Suzana TURKU	ZV / Minister
4	MIN.E BRENDESHME	Ferdinand PONI	ZV / Minister
5	MIN.E PUNEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT & TELEKOMUNIK.	Stavri RISTANI	ZV / Minister
6	MIN.E MJEDISIT, UJRAVE & ADMINISTRIMIT TE PYJEVE	Taulant BINO	ZV / Minister
7	MIN.E BUJQESISE, USHQIMIT & MBROJTJES KONSUMAT.	Ndoc FASLLIA	ZV / Minister
8	MIN.E PUNES, ÇESHTJ. SOC. & SHANSEVE TE BARABARTA	Kastriot SULKA	ZV / Minister
9	MIN.E FINANCAVE	Sherefedin SHEHU	ZV / Minister
10	MIN.E INTEGRIMIT EUROPIAN	Albert GAJO	ZV / Minister
11	MIN.E EKONOMISE, TREGTISE & ENERGJETIKES		
12	INSTAT	Ines NURJA	Drejtores
13	ALBINVEST	Denis KALENJA	Drejtor
14	FSHZH	Benet BECI	Drejtor Ekzekutiv
15	AZHSM (MADA)	Shkelzen MARKU	Drejtor Ekzekutiv

Perfaqesues te institucioneve dhe organizatave te Qeverisjes Vendore

N/R	INSTITUCIONI / ORGANIZATA	PERFAQESUESI	FUNKSIONI / POZICIONI
1	KESHILLI I QARKUT TIRANE	Tahsim MEMA	Kryetar I Keshillit Qarkut
2	KESHILLI I QARKUT DURRES	Sabah STAFUKA	ZV/Kryetar I Keshillit Qarkut
3	KESHILLI I QARKUT FIER	Luan MUÇAJ	Kryetar I Keshillit Qarkut
4	KESHILLI I QARKUT BERAT	Pelivan SHATRI	Kryetar I Keshillit Qarkut
5	KESHILLI I QARKUT ELBASAN	Ardjan TURKU	Kryetar I Keshillit Qarkut
6	KESHILLI I QARKUT KORCE	Ilija MILO	Kryetar I Keshillit Qarkut
7	KESHILLI I QARKUT VLORE	Agron SHARRA	Kryetar I Keshillit Qarkut
8	KESHILLI I QARKUT GJIROKASTER	Arben ÇULLI	Kryetar I Keshillit Qarkut
9	KESHILLI I QARKUT LEZHE	Bardh RICA	Kryetar I Keshillit Qarkut
10	KESHILLI I QARKUT SHKODER	Gjovalin KOLOMBI	Kryetar I Keshillit Qarkut
11	KESHILLI I QARKUT KUKES	Shefqet BRUKA	Kryetar I Keshillit Qarkut
12	KESHILLI I QARKUT DIBER	Ramazan MJESHTRI	ZV/Kryetar I Keshillit Qarkut
13	SHOQATA E QARQEVE	Hysen DOMI	Drejtor Ekzekutiv
14	SHOQATA E BASHKIVE	Fatos HODO	Drejtor Ekzekutiv
15	SHOQATA E KOMUNAVE	Agim RREDHI	Antar I Komit. Drejtues

Perfaqesues te Sektorit privat dhe Shoqerise Civile

N/R	INSTITUCIONI / ORGANIZATA	PERFAQESUESI	FUNKSIONI / POZICIONI
1	UNIONI I DHOMAVE TE TREGTISE DHE INDUSTRISE	Ilir ZHILLA	Kryetar
2	KESHILLI I AGROBIZNESIT	Zyhdi TEQJA	Drejtore Ekzekutive
3	KONFEDERATA E ARTIZANATIT SHQIPTAR	Petrit METOHU	Drejtore Ekzekutive
4	SHOQATA E BANKAVE	Elvin MEKA	Sek. I Pergj. I Shoqates
5	QENDRA E KOORDINIMIT TE ARZH-ve	Ilir RREMBECI	Drejtore Ekzekutive I ARZH Tirane
6	QENDRA E PROMOVIMIT TE ZHVILLIMIT NJEREZOR (HDPC)	Lindita XHILLARI	Drejtore Ekzekutive
7	INSTITUTI I STUDIMEVE BASHKEKOHORE (ISB)	Artan HOXHA	President
8	CoPLAN	Dritan SHUTINA	Drejtore Ekzekutive
9	UNIVERSITETI TIRANES (FAKULTETI EKONOMIK)	Dhori KULE	Dekan
10	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES	Perparim HOXHA	Rektor
11	UNIONI OPERATOREVE TURISTIKE	Sadik MALAJ	Kryetar
12	ECAT-Tirana	Marieta MIMA	Drejtore
13	INSTITUTI I KERKIMEVE URBANE	Zana VOKOPOLA	Drejtore Ekzekutive
14	AGJENCIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK TE QENDRUESHEM	Genc MYFTIU	Drejtore Ekzekutive
15	FOREIGN INVESTORS ASSOCIATION OF ALBANIA	Patrick PASCAL	ZV/President

Aneksi 3: Strategjia për Zhvillimin e Qarkut – një bazë e mundshme.

SZHQ-ja është dokumenti kryesor i planifikimit në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm shoqëror-ekonomik të çdo qarku. Plani i veprimit i SZHQ-së është dokumenti i detajuar operativ që mundëson zbatimin e SZHQ-së.

Objektivat e Strategjisë për Zhvillimin e Qarkut janë si më poshtë:

- Të shërbejë si një marrëveshje konsensuale mes të gjithë palëve të interesuara përkatëse në vend, të qarkut, bashkisë dhe komunës në lidhje me nevojat për zhvillim që ka qarku (për sa i përket zhvillimit ekonomik, punësimit dhe trajnimit, nevojave në infrastrukturë, mjedisit, zhvillimit lokal, urban dhe rural, përpjekjet për zgjidhjen e problemit të varfërisë dhe përjashtimit social) dhe në këtë mënyrë të sigurojë bazën e nevojshme për zhvillimin e bisedimeve, harmonizimin dhe financimin e aktiviteteve të përcaktuara brenda strategjisë.
- Të bëjë përpjekje për të arritur objektivat strategjike të përbashkëta me qarqet e tjera fqinje si edhe nevojat ndër-kufitare (ku shihet e arsyeshme) dhe ndër-rajonale si dhe mundësitë që ofrohen.
- Të sigurojë udhëzimet bazë për planet e projektet për zhvillimin lokal që disponojnë bashkitë/komunat.

SZHQ-ja është hartuar deri në detaj për një periudhë 5 vjeçare. Plani i veprimit është përgatitur për një periudhë dy vjeçare.

Udhëzimet kombëtare do të sigurojnë një kontekst më të gjerë për politikat dhe procedurat për përpunimin e SZHQ-së, duke specifikuar gjithashtu temat për zhvillim që përbëjnë prioritet kombëtar dhe në BE. Brenda këtij kuadri secilës SZHQ do t'i kërkohet të përfshijë kapituj të detyrueshëm që të mbulojnë si më poshtë:

- Kapitulli 1: Një përshkrim sasior të gjendjes aktuale për sa i përket mospajtimeve/ dallimeve, boshllëqeve dhe potencialit për zhvillim në qark (ku përfshihet një analizë të tendencave në qark, Shqipëri dhe BE; një analizë të problemeve dhe nevojave që kanë zonat e pafavorizuara brenda qarkut; një analizë të gjendjes aktuale, problemeve dhe nevojave për bashkëveprim ndër-kufitar dhe ndër-rajonale).
- Kapitulli 2: Rezultatet e arritura dhe burimet financiare të përdorura me efikasitet në Strategjitë e mëparshme të Zhvillimit të Qarkut (jo të ndërmarra në raundin e parë të SZHQ) siç përcaktohen nga një vlerësim i pavaruar.
- Kapitulli 3: Një analizë SWOT (e pikave të forta, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve) të qarkut bazuar në përfundimet e arritura në Kapitujt 1 dhe 2.
- Kapitulli 4: Vizioni i SZHQ-së dhe hierarkia e objektivave të strategjisë së zhvillimit të qarkut që del nga analiza SWOT.
- Kapitulli 5: Një përshkrim të strategjisë për të arritur objektivat e referuara në Kapitullin 4.

- Kapitulli 6: Prioritetet e përzgjedhura për zhvillimin e qëndrueshëm shoqëror-ekonomik të qarkut së bashku me qëllimet e tyre specifike sasiore, prova të përputhjes me udhëzimet kombëtare dhe përshkrimet e detajuara të ndërhyrjeve specifike për sa l përket:
 - I. Prioriteteve në lidhje me zhvillimin e zonave të pafavorizuara të qarkut;
 - II. Prioriteteve për bashkëpunimin ndër-kufitar (ku duhet) dhe ndër-qarkor të qarkut;
 - III. Prioriteteve në lidhje me integrimin në planet e zhvillimit lokal (ku ato ekzistojnë);
- Kapitulli 7: Një plan financimi tregues për Strategjinë e Zhvillimit të Qarkut, ku për secilin prioritet e secilin vit specifikohet ndarja e fondeve i parashikuar për kontributin e secilit prej institucioneve qeveritare në vend, qark, bashki dhe komunë.
- Kapitulli 8: Një përshkrim i masave të marra për administrimin e SZHQ-së dhe sistemeve për monitorimin dhe vlerësimin e SZHQ, duke përfshirë:
 - I. Përkufizimin e roleve që kanë palët e ndryshme në vend, në qark, bashki dhe komunë në administrimin dhe zbatimin e SZHQ-së;
 - II. Rolet dhe përgjegjësitë përkatëse të partnerëve në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të SZHQ-së.
- Aneks 1: Një përshkrim i rezultateve të nxjerra nga konsultimet e bëra me Këshillin e Partneritetit të Qarkut në përgatitjen e SZHQ, masat e marra dhe dispozitat e parashikuara për përfshirjen e Këshillit të Partneritetit të Qarkut gjatë monitorimit të saj.
- Aneks 2: Raport i vlerësimit *ex ante* (në bazë parashikimesh e jo rezultatesh) për SZHQ-në.

Dokumenti i SZHQ-së për implementimin është Plani i Veprimit, në të cilin aktivitetet dhe buxheti i nevojshëm për zbatimin e SZHQ-së përcaktohen gjatë një periudhe dy vjeçare.

Plani i Veprimit përmban seksionet e mëposhtme:

- Projektet që duhen implementuar përpos prioriteteve të ndryshme në SZHQ.
- Treguesit përkatës të monitorimit për çdo projekt
- Në rastin kur projekti që duhet mbështetur është skemë granti, përmban kriteret për përzgjedhjen e veprimeve të financuara sipas secilës masë, përfshirë metodën për vlerësimin e realizueshmërinë së tyre paraprakisht.
- Planin e financimit ku, për çdo projekt, specifikohet ndarja e fondeve e parashikuar për kontributin e secilit nga institucionet qeveritare në vend, të qarkut, bashkisë dhe/ose komunës. Plani i financimit duhet ta bëjë të qartë nëse fondet e planifikuara janë llogaritur në buxhetin e institucioneve qeveritare të interesuara në vend, qark, bashki.

Ky informacion duhet të plotësohet me një tabelë përmbledhëse të burimeve financiare publike (të ndara në kombëtare, rajonale dhe lokale), private dhe te BE-se që caktohen dhe i korrespondojnë secilit projekt të miratuar në Planin e Veprimit.

Bashkëpunimi mes qarqeve do të mbështetet nëpërmjet nxitjes së **“projeketeve të përbashkëta të zhvillimit”** të cilat do të identifikohen në SZHQ e qarqeve që dëshirojnë të bashkëpunojnë me njëritjetrin. “Projekte të përbashkëta zhvillimi” të tilla do të nxitin nëpërmjet shtimit të fondeve, pakësimit të kërkesave që duhet të plotësohen për bashkëfinancime dhe ponderimit përzgjedhës. Ky informacion do të plotësohet me një tabelë të përgjithshme treguese të financimit ku jepen të përmbledhura burimet financiare publike (të ndara në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal), private dhe (ku është e aplikueshme) të BE-së të caktuara dhe që i korrespondojnë çdo projekti të miratuar në Planin e Veprimit.

Agjensia për Zhvillimin e Qarkut do të përgjigjet për hartimin e Strategjisë për Zhvillimin e Qarkut. Përgatitja e saj, në bazë të Udhëzimeve Kombëtare, do të ndërmerret në përputhje me Parimin e Partneritetit e si rrjedhim në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Partneritetit të Qarkut. Shkalla dhe natyra e përfshirjes së Këshillit të Partneritetit të Qarkut në përgatitjen e SZHQ-së do të përshkruhet në Shtojcën 1 të SZHQ-së.

Draftet e SZHQ-ve të paraqitura në Këshillin e Partneritetit të Qarkut për t'u shqyrtuar vihen në dispozicion të publikut nëpërmjet internetit; duhet të ftohen anëtarë të publikut që të bëjnë të njohura pikëpamjet e tyre nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në KPQ.

Duhet të kryhet një vlerësim i pavarur *ex ante* gjatë procesit të përpunimit të Strategjisë për Zhvillimin e Qarkut. Vlerësuesit dhe përgjegjësit për hartimin e SZHQ, duhet të punojnë sistematikisht me aspektet e larmishme të strategjisë për të siguruar se ka lidhje me dhe është e përshtatshme për nevojat që ka qarku. Objektivi që synohet të arrihet është përmirësimi dhe forcimi i cilësisë së SZHQ, sigurimi i koherencës së saj me udhëzimet kombëtare, gjasat për financimin buxhetor të parashikuar dhe realizmin e periudhës së caktuar kohore për implementim; duke rritur kështu efektshmërinë dhe impaktin e ndërhyrjeve që mbështeten nga autoritetet (kombëtare, rajonale dhe/ose lokale). Në lidhje me këtë, vlerësimi duhet të mundësojë/ndihmojë që të ketë një dialog konstruktiv mes atyre që janë përgjegjës për SZHQ dhe vlerësuesve.

Këshilli i Qarkut do të jetë përgjegjës për miratimin e SZHQ dhe Planin e saj të Veprimit. Procesi i miratimit do të jetë publik dhe transparent dhe përpara se të japë miratimin për SZHQ-në, Këshilli i Qarkut do të kërkojë dhe do t'i marrë parasysh pikëpamjet e:

- . Këshillit të Partneritetit të Qarkut.
- . Ekipit të vlerësimit *ex ante*

Plani i Veprimit do të jetë tema e bisedimeve që do të zhvillohen mes institucioneve qeveritare të pushtetit qendror, të qarkut, bashkisë dhe komunës lidhur me projektet e investimeve që kërkojnë mbështetje financiare për realizimin e SZHQ.

Kjo marrëveshje do të parashtrohet në një Marrëveshje për Zhvillimin e Qarkut mes Institucioneve qeveritare të pushtetit Qendror, të Qarkut, Bashkisë dhe Komunës. Nënshkrimi nga pushteti qendror i Marrëveshjes për Zhvillimin e Qarkut do të jetë edhe miratimi i saj që pushteti qendror të financojë vazhdimësinë e SZHQ dhe si rrjedhim miratimin *de facto* të SZHQsë.

Aneksi 4: Marrëveshja për Zhvillimin e Qarkut – një bazë e mundshme

Marrëveshja për Zhvillimin e Qarkut do të formalizojë angazhimin nga ana e institucioneve qeveritare qendrore, të qarkut dhe bashkisë/komunës për të financuar së bashku implementimin e Planit të Veprimit të një Strategjie të miratuar për Zhvillimin e Qarkut.

Marrëveshja për Zhvillimin e Qarkut do të jetë një kontratë e vetme mes pushtetit qendror, qarkut dhe bashkive/komunave brenda qarkut të cilët po shpenzojnë para për zbatimin e Planit të Veprimit. Do të ketë një Marrëveshje për Zhvillimin e Qarkut që do të mbulojë kështu çdo qark.

Marrëveshja për Zhvillimin e Qarkut do të përmbajë:

- Përcaktimin e palëve kontraktuese në Marrëveshjen për Zhvillimin e Qarkut (siç është përcaktuar më sipër)
- Angazhimin për financimin e zbatimit të Planit të Veprimit për Strategjinë e miratuar për Zhvillimin e Qarkut.
- Shuma e përgjithshme e fondeve të caktuara për financimin e zbatimit të Planit të Veprimit me ndarjen e planifikuar vjetore të fondeve si dhe burimet e planifikuara financiare (kombëtare, të qarkut, dhe bashkisë/komunës) me pjesën nga secili burim.
- Periudha e vlefshmërisë së Marrëveshjes për Zhvillimin e Qarkut. Kjo duhet të jetë në përputhje me periudhën e buxhetimit shumë-vjetor të qeverisë.
- Detyrimet në lidhje me vlerësimin e arritjeve nga Marrëveshja për Zhvillimin e Qarkut të qëllimeve të përcaktuara më pare.

Marrëveshja për Zhvillimin e Qarkut do të përmbajë një sërë shtojcash. Çdo shtojcë do të përcaktojë:

- Angazhimin financiar të saktë dhe të përlogaritur individual të një ministrie, qarku, bashkie apo komune në lidhje me zbatimin e Planit të Veprimit dhe për çfarë duhet të përdoret ai angazhim financiar. Meqë flasim për financim të investimeve duhet të jetë e mundur që kjo të përcaktohet në bazë projekti-pas-projekti. Plani i Veprimit të SZHQ-së duhet të jetë i detajuar në mënyrë të mjaftueshme që ta bëjë të mundur një gjë të tillë.
- Bazën e shpenzimeve të detyrimit financiar në qark nga ministria, qarku, bashkia apo komuna (shpenzime direkte nga pushteti qendror, bashkëfinancimi i shpenzimeve të qarkut/bashkisë/komunës, shfrytëzim i deleguar i financës së buxhetit kombëtar nga ana e autoriteteve të qarkut/bashkisë, etj.).
- Procedurat, të dhënat dhe afatet kohore për raportimin mbi zbatimin e veprimeve të financuara dhe përdorimin e veprimeve të financuara dhe shfrytëzimin e fondeve të akorduara.
- Procedurat dhe grafiku kohor për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të veprimeve të financuara dhe shfrytëzimi i fondeve të akorduara.

Nga sa u tha më sipër duhet të jetë e qartë se Strategjia për Zhvillimin e Qarkut dhe Plani i saj I Veprimit përbëjnë elementin kyç të Marrëveshjes për Zhvillimin e Qarkut. Procesi i negociimit për arritjen e Marrëveshjes për Zhvillimin e Qarkut do të zvogëlohet dhe thjeshtohet ndjeshëm nëse mund të sigurohet që Strategjia për Zhvillimin e Qarkut dhe Plani i saj i Veprimit të jenë plotësisht në përputhje me prioritetet kombëtare (dmth, ato mbulojnë atë që do të bëjë qeveria), ato janë realiste dhe të zbatueshme.

Kemi tre veprime për të siguruar një gjë të tillë:

- Udhëzimet Kombëtare për SZHQ dhe PV: Këto udhëzime duhet të paraqesin në mënyrë të qartë dhe të pakontestueshme atë që qeveria do që ta shohë të financuar, Si? dhe nga Kush?. Kjo pashmangërisht nënkupton që Udhëzimet Kombëtare duhet të përcaktojnë politikën e qeverisë për investimet në bazë sektori. Një gjë e tillë duket e pashmangshme në rast se Strategjitë për Zhvillimin e Qarkut nuk do të përmbajnë projekte që Qeveria jo vetëm që nuk do që t'i financojë vetë, por nuk do as t'i financojë ndonjë tjetër (pasi ose nuk janë në përputhje me politikën e miratuar kombëtare ose janë fusha ku qeveria nuk dëshiron që të përfshihet pushteti lokal).
- Pjesëmarrja e pushtetit qendror në Këshillin e Partneritetit të Qarkut në rishikimin e Strategjisë për Zhvillimin e Qarkut.
- Vlerësimi *ex ante* i cili do të përpiqet të sigurojë që Udhëzimet Kombëtare të jenë ndjekur, që buxheti është realist në lidhje me buxhetin kombëtar, buxhetin e qarkut dhe buxhetet e bashkisë/komunës dhe që grafiku kohor për implementimin është realist.

Këto kërkesa duhet të sigurojnë që Agjensitë për Zhvillimin e Qarkut që përgatisin Strategjinë për Zhvillimin e Qarkut duhet të punojnë në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë nëse duan që SZHQ e tyre të miratohen dhe financohen. Kështu, pjesa më e madhe e bisedimeve duhet të zhvillohen joformalisht gjatë përgatitjes së SZHQ.

METE duhet të veprojë që të mbështesë dhe lehtësojë procesin e bisedimeve në të gjitha fazat. METE duhet të ketë anëtarë specifikë në staf që përgjigjen për komunikimin dhe zhvillimin e bisedimeve me ministri të tjera të linjës dhe me MZHQ-të për të marrë masa që të lehtësohet procesi dhe për të minimizuar keqkuptimet mes pushtetit qendror-qarkut.

Roli i Këshillit Kombëtar të Partneritetit për Zhvillimin Rajonal në këtë aspekt si pasojë duhet të jetë zgjidhja e mosmarrëveshjeve (për sa i përket interpretimit të Udhëzimeve Kombëtare apo mosmarrëveshjeve për sa i përket vlefshmërisë së komenteve të vlerësimeve *ex ante*). Duhet të konsiderohet si Gjykata e Apelit e jo tribunal bisedimesh.

Nga kjo duhet të jetë e qartë se procesi do të kërkojë një nivel bashkëpunimi të panjohur aktualisht mes autoriteteve kombëtare, të qarkut, bashkisë dhe komunës. Kështu, rekomandohet që të fillohet me fonde të kufizuara caktuar për një numër të vogël prioritetesh tek të cilët ka mundësi të ketë konsensus të gjerë mes tri niveleve të pushtetit. Shumat që i adresohen qarqeve nëpërmjet marrëveshjeve për zhvillimin e qarkut mund të shtohen gradualisht ndërkohë që administrata qendrore dhe strukturat e qarkut fitojnë më shumë përvojë në bashkëpunimin e ndërsjellë në fushën e politikës për zhvillimin rajonal.

Marrëveshja për Zhvillimin e Qarkut është e lidhur pazgjidhshmërisht me buxhetin shumë-vjetor të qeverisë (i cili i siguron fonde për implementimin).

Faza e parë e miratimit të Marrëveshjes për Zhvillimin e Qarkut si rrjedhim duhet të jetë miratimi i buxhetit shumë-vjetor që akordon fondet e nevojshme të pushtetit qendror (brenda buxheteve individuale të Ministrive) për zbatimin e secilit prej Planeve të Veprimit të Strategjive për Zhvillimin e Qarkut.

Pas një miratimi të tillë pushteti qendror duhet të ndihet i autorizuar për të nënshkruar Marrëveshjen për Zhvillimin e Qarkut.

Duke pasur parasysh natyrën në thelb financiare të Marrëveshjes për Zhvillimin e Qarkut si dhe natyrën shumë-Ministore të angazhimit ndoshta gjëja më e përshtatshme është që Ministria e Financave të nënshkruajë marrëveshjet në emër të pushtetit qendror.

Çdo qark, padyshim, duhet të nënshkruajë Marrëveshjen për Zhvillimin e Qarkut për të pasqyruar angazhimet e tyre brenda Planit të Veprimit.

Bashkitë dhe komunat që janë angazhuar financiarisht për sa i përket Planit të Veprimit duhet gjithashtu të nënshkruajnë Marrëveshjen për Zhvillimin e Qarkut.